



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 121

Datë 5 gusht 2014

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr. 79/2014 datë 10.7.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria AG, lidhur me financimin e projektit “Modernizimi i sistemit arsimor në Shqipëri nëpërmjet e-edukimit” 5625
Ligj nr. 81/2014 datë 17.7.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e parë të politikës së zhvillimit për financat publike 5637
Ligj nr. 82/2014 datë 17.7.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit për modernizimin e sektorit financiar 5643
Vendim i Kuvendit nr. 52/2014 datë 24.7.2014	Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 5648
Rezolutë e Kuvendit datë 24.7.2014	Për vlerësimin e punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2013 5648
Rezolutë e Kuvendit datë 24.7.2014	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2013 5649
Vendim i KZHR nr. 11, datë 1.8.2014	Për shpërndarjen e fondit për arsimin, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve..... 5651

Vendim i KZHR nr. 12, datë 1.8.2014	Për detajimin e përdorimit dhe ndarjes së fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.....	5653
Kërkesë e MK nr.3460, datë 31.7.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme që preken nga zbatimi i projektit “Për ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin “Nënë Tereza””.....	5654

LIGJ
Nr. 79/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË
KREDISË PËR EKSPORT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NË EMËR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
PËRFAQËSOHET NGA MINISTRIA E
FINANCIVE, DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA
AG, LIDHUR ME FINANCIMIN E PROJEKTIT
“MODERNIZIMI I SISTEMIT ARSIMOR NË
SHQIPËRI NËPËRMJET E-EDUKIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave, dhe UniCredit Bank Austria AG, lidhur me financimin e projektit “Modernizimi i sistemit arsimor në Shqipëri nëpërmjet e-edukimit”, me një hua të butë prej 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) eurosh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8650, datë 30.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE KREDIE EKSPORTI
HUA E BUTË NR. 232.640 PËR NJË SHUMË
MAKSIMALE PREJ 3,500,000 EURO, DATË . 2014
E LIDHUR NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
QË VEPRON NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE I PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE (SI “HUAMARRËS”)
DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG (SI
HUADHËNËS) NË LIDHJE ME FINANCIMIN E
PROJEKTIT “ARSIMIMI ELEKTRONIK - SHQIPËRI
- MODERNIZIMI I SISTEMIT ARSIMOR”

Kjo marrëveshje kredie eksporti për një hua të butë nr. 232.640 për një shumë maksimale prej 3,500,000

euro (Marrëveshja) është e datës2014, e lidhur ndërmjet Huamarrësit, të specifikuar në aneksin 1 (Huamarrësi) dhe Huadhënësit (Huadhënësi), të specifikuar në aneksin 1.

1. PËRKUFIZIMET

Në këtë Marrëveshje dhe në anekset e saj, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

“Datë e pranimi” është data në të cilën kjo Marrëveshje nënshkruhet nga të dyja palët dhe ratifikohet nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

“Aneks” është një aneks në këtë Marrëveshje, termat e të cilit konsiderohen të jenë të përfshira në këtë Marrëveshje dhe përbëjnë pjesë të saj.

“Periudhë e disponueshmërisë” janë afatet e specifikuar në aneksin 3, gjatë të cilave huamarrjet mund të tërhiqen nga Shuma e Kredisë.

“Huamarrje” është një shumë e tërhequr nga Huamarrësi nga Shuma e Kredisë.

“Ditë punë” është një ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë dhe transaksionet dhe depozitat në monedhë të huaj ndërmjet bankave mund të kryhen në Vjenë dhe në Tiranë.

“Data e mbylljes” është data e përcaktuar në seksionin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

“Shuma e kredisë” është shuma e specifikuar në aneksin 3 kundrejt së cilës Huamarrësi mund të tërheqë huamarrjet gjatë periudhës së disponueshmërisë.

“Euro” ose “€” monedha e vetme e atyre shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që miratojnë euron si monedhë të tyre në pajtim me legjislacionin e Komunitetit Evropian në lidhje me Bashkimin Evropian Ekonomik dhe Monetar.

“EURIBOR” do të thotë norma ndërbankare e ofruar administrohet nga Federata Bankare e Bashkimit Evropian (ose çdo person tjetër i cili merr përsipër administrimin e kësaj norme) shfaqur në faqen e ekranit të EURIBOR01 të Reuters (apo çdo zëvendësim i Reuters, faqe e cila tregon se norma interesit apo faqja e duhur e ndonjë shërbimi informativ i cili publikon këtë normë nga koha në kohë nga Reuters, siç përcaktohet nga huadhënësit) për ofrimin e depozitave në euro për një periudhë të krahasueshme me periudhën e interesit për huan përkatëse në ose rreth orës 11:00 në Bruksel në ditën e dytë të punës para fillimit të periudhës përkatëse të interesit dhe, nëse ndonjë normë e tillë është zero ose nën zero, EURIBOR do të konsiderohet të jetë zero. Norma e tillë do të përcaktohet në bazë të një viti prej 360 ditësh.

“Llogaria e Huas” është llogaria e hapur në emër të Huamarrësit në pajtim me dispozitat e seksionit 2.3.

“Data e pranimi përfundimtar” do të thotë data në të cilën Huadhënësi ka marrë nga eksportuesi i projektit kopjen e protokollit të pranimi përfundimtar të miratuar nga blerësi i projektit.

“Data të pagesës së interesit” është 31 marsi, 30 qershori, 30 shtatori dhe 31 dhjetori i çdo viti, me kusht që nëse një nga këto data nuk është ditë punë, referencat ndaj kësaj date do të jenë ndaj ditës më të afërt pararendëse të punës.

“Periudhë interesi” është një periudhë:

- i) që fillon në datën e huamarrjes ose në ditën e fundit të periudhës së saj të mëparshme të interesit, dhe
- ii) që mbaron më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator ose 31 dhjetor në çdo vit.

“Barrë” është çdo hipotekë, tarifë, peng, barrë, hipotekim, detyrim, ruajtje titulli ose çdo interes tjetër garancie të çdo lloji dhe që ka lindur në çdo lloj mënyre.

“Hua” është shuma e përgjithshme e principalit të huamarrjeve të tërhequra sipas Shumës së Kredisë dhe ende të papaguara.

“Datat e shlyerjes së detyrueshme” nënkupton datat në çdo vit, të përcaktuara në aneksin 3, me kusht që nëse një nga këto data nuk është ditë pune, referencat ndaj kësaj date do të jenë ndaj ditës më të afërt pararendëse të punës.

“OeKB” është Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft, Am Hof 4, 1011 Vienna, Austria, që vepron si Agjenci Kredie Eksporti për dhe në emër të Republikës së Austrisë.

“Garanci e OeKB-së” do të thotë një garanci me nr. 232.640 e lëshuar nga OeKB-ja si agjente e Republikës së Austrisë në lidhje me Llogarinë e Huas për dhe në emër të Republikës së Austrisë, në përputhje me Aktin e vitit 1981 (i ndryshuar) mbi promovimin e eksportit.

“Procedurë pagine” është procedura për pagesën e Huamarrjeve të përcaktuara në aneksin 4.

“Projekti” është projekti i përcaktuar në aneksin 2.

“Blerës i Projektit” është Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Tiranë, Republika e Shqipërisë (e njohur më parë si Ministria e Arsimit dhe Shkencës), siç përcaktohet në aneksin 2.

“Eksportues i Projektit” është eksportuesi austriak i përcaktuar në aneksin 2.

“Marrëveshje e Blerjes” është marrëveshja në lidhje me Projektin e lidhur ndërmjet Eksportuesit të Projektit dhe Blerësit të Projektit dhe e përcaktuar në aneksin 2.

“Seksion” është një pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

2. SHUMA E KREDISË

2.1 Hyrje

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i termave dhe kushteve, sipas të cilave Huadhënësi do të financojë 100% të vlerës së përgjithshme të kontratës (por deri në një shumë maksimale të specifikuar si “Shuma e Kredisë” në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje) që duhet të paguhet nga Blerësi i Projektit për Eksportuesin e Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes.

2.2 Shuma e Kredisë

Huadhënësi bie dakord t'i vërë në dispozicion Huamarrësit Shumën e Kredisë gjatë periudhës së disponueshmërisë sipas termave dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, me kusht që një Huamarrje mund të bëhet nga Huamarrësi sipas Shumës të Kredisë në pajtim me procedurën e pagesës së përcaktuar në aneksin 4 dhe zbatohet kundrejt pagesës së çmimit të kërkueshëm ndaj Eksportuesit të Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes.

Kredia e dhënë jepet sipas dhe në përputhje me dispozitat e rregullave dhe rregulloreve për kreditë e eksportit të shpallura nga Republika e Austrisë. Huamarrësi nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje thekson që financimi mbështetet nga fondet e ndihmës publike me një element granti prej 35,30 % (tridhjetë e pesë pike tridhjetë për qind).

Huadhënësi mund të refuzojë disbursimin e një Huamarrjeje nëse kjo Huamarrje dhe interesi mbi të nuk do të mbulohej nga garancia e dhënë nga OeKB-ja për dhe në emër të Republikës së Austrisë në pajtim me Aktin 1981 mbi promovimin e eksportit, i ndryshuar, dhe/ose marrëveshja e rifinancimit me OeKB-në për Shumën e Kredisë pushon së qeni në fuqi.

2.3 Llogaria e Huas

Huadhënësi hap një llogari në euro në emrin e Huamarrësit, të përcaktuar si “Llogaria e Huas”. Çdo huamarrje e bërë sipas kësaj Marrëveshjeje debitohet në Llogarinë e Huas, në pajtim me këtë Marrëveshje, me vlerë në datën e pagesës së kësaj Huamarrjeje. Shlyerjet dhe parapagimet aplikohen përkatësisht në Llogarinë e Huas.

2.4 Pavarësia e Marrëveshjes dhe Marrëveshjes së Blerjes

Kjo Marrëveshje dhe Marrëveshja e Blerjes janë marrëveshje të veçanta dhe të pavarura. Asnjë dështim i Eksportuesit të Projektit në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Blerjes nuk ndikon te detyrimet e Huamarrësit ndaj Huadhënësit, as nuk e bën Huadhënësin përgjegjës për dështimin e Eksportuesit të Projektit dhe/ose të ndonjë pale tjetër të Marrëveshjes së Blerjes.

3. INTERESI

3.1 Interesi për Llogarinë e Huas

Huamarrësi pagan interesin në datat e pagesës së interesit me një normë fikse, sipas përcaktimit në aneksin 3 të llogaritur mbi shumën e papaguar të kredisë.

3.2 Llogaritja dhe data për pagesën e interesit

Interesi i kërkueshëm në pajtim me Seksionin 3.1 i grumbulluar ditë pas dite, llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara për Periudhën përkatëse të Interesit dhe një viti me 360 ditë, dhe, përveç sa parashikohet në Seksionin 6.1, do të paguhet në fund të

çdo tre mujori nga Huamarrësi Huadhënësit në datat e pagesës së interesit.

3.3 Kamatëvonesa

Në rast të pamundësisë së Huamarrësit për të kryer në datën e duhur pagesën e çdo shume të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të paguajë interes mbi këtë shumë nga data e kësaj mospagese deri në datën e pagesës aktuale në normën e caktuar në aneksin 3. Kamatëvonesa sipas këtij seksioni 3.3 do të jetë e kërkueshme në datat e pagesës së interesit.

4. TARIFAT DHE SHPENZIMET

4.1 Tarifa e angazhimit financiar

Për periudhën që fillon në datën e mbylljes dhe që mbaron në fund të periudhës së disponueshmërisë, Huamarrësi i paguan Huadhënësit një tarifë angazhimi në normën e caktuar në aneksin 3. Tarifa e angazhimit financiar, e kërkueshme në pajtim me këtë seksion 4.1, llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti prej 360 ditësh nga Huadhënësi mbi balancën e patërhequr të Shumës së Kredisë në fillim të çdo tremujori kalendarik dhe paguhet në fund të çdo periudhe nga Huamarrësi Huadhënësit në datat e pagesës së interesit. Paga e parë e tarifës së angazhimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet në datën e parë të pagesës së interesit pas datës së mbylljes.

4.2 Tarifa e menaxhimit

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas datës së mbylljes (por jo më vonë se 5 ditë pune para disbursimit të parë të Shumës të Kredisë) do t'i paguajë Huadhënësit tarifën e menaxhimit të përcaktuar në aneksin 3.

4.3 Shpenzimet

i) Huamarrësi i paguan më tej Huadhënësit, me kërkesë, shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara (përfshirë shpenzimet ligjore, të përkthimit dhe udhëtimit dhe shpenzimet mbi garancinë e OeKB-së) të bëra nga Huadhënësi në lidhje me padinë për kompensim të çdo shume të kërkueshme për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje.

ii) Të gjitha taksat, tatimet, shpenzimet ose detyrimet e tjera të vendosura për Huadhënësin nga Ministria e Financave, Shqipëri, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jenë për llogari të Huamarrësit dhe të pagueshme nga Huamarrësi për Huadhënësin.

4.4 Primi i garancisë

Sipas Marrëveshjes, Huadhënësi i faturon Huamarrësit një kompensim për primin e garancisë së OeKB-së në mënyrën e mëposhtme:

(i) Primi i garancisë së OeKB-së dhe tarifa e administrimit të OeKB-së e pagueshme në fillim

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas datës së mbylljes (por jo më vonë se 5 ditë pune para disbursimit të parë të Shumës së Kredisë) do t'i

paguajë Huadhënësit një pjesë fillestare të kompensimit për primin e garancisë të OeKB-së dhe tarifën e administrimit të përcaktuar në aneksin 3 në shumat e përcaktuara në aneksin 3.

(ii) Primi i garancisë së OeKB-së i pagueshëm si marzh

Duke filluar nga data e pagesës së interesit që është pas datës së mbylljes, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit kompensimin për primin e garancisë së OeKB-së, të pagueshëm si marzh, të përcaktuar në aneksin 3. Marzhi i primit të garancisë së OeKB-së është i kërkueshëm dhe i pagueshëm çdo tre muaj në datat e pagesës së interesit.

Grafiku i pagesës së shumave që duhet të paguhet sipas seksionit 4.4 do të përcaktohet në garancinë përfundimtare të lëshuar nga OeKB-ja. Huadhënësi do të informojë Huamarrësin përkatësisht për lëshimin e garancisë dhe grafikun e pagesës dhe ky njoftim bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Nëse gjatë afatit të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit, primi i garancisë së OeKB-së rritet për shkak se: (i) vlerësimi i riskut tregtar të bërë nga OeKB-ja në lidhje me lëshimin e garancisë së OeKB-së ka ndryshuar; ose (ii) ndryshimet thelbësore në kushtet kontraktuale të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit janë miratuar, Huamarrësi rimbursion Huadhënësin për këtë rritje sipas kërkesës.

5. SHLYERJA

5.1 Shlyerja e detyrueshme

Huaja e papaguar në fund të periudhës së disponueshmërisë do të shlyhet nga Huamarrësi në një numër të barabartë këstesh gjashtë mujore shlyerjeje në datat e shlyerjes së detyrueshme, të përcaktuara në aneksin 3. Huadhënësi, brenda 15 ditëve kalendarike pas datës së pranimit të përkohshëm, do të njoftojë Huamarrësin për listën e datave të shlyerjes së detyrueshme dhe shumat e kërkueshme në secilën prej këtyre datave.

5.2. Parapagimi opsional

Huamarrësi mund të parapaguajë Huan plotësisht ose pjesërisht (nëse pjesërisht, në shumën e përcaktuar në aneksin 3 ose shumëfishat integralë të saj) pas dhënies së një njoftimi me shkrim të paktën tridhjetë (30) ditë kalendarike para (ky njoftim është i pakthyeshëm) datës së propozuar të parapagimit për Huadhënësin në bazë të aprovimit të OeKB-së dhe pagesave të çdo kostoje ekuivalente me humbjen e llogaritur të shkaktuara nga Huadhënësi. Çdo parapagesë e tillë, nëse bëhet gjatë periudhës së disponueshmërisë, do të zvogëlojë vlerën e Shumës së Kredisë me një vlerë të barabartë me këtë parapagesë. Çdo referencë ndaj Shumës së Kredisë në këtë Marrëveshje më pas konsiderohet të jetë referencë ndaj shumës së caktuar në aneksin 3, të reduktuar. Nëse kryhet pas mbarimit të periudhës së disponueshmërisë,

çdo parapagesë i tillë do të aplikohet për të reduktuar me shumë të barabarta këstet e shlyerjes së kërkueshme në një kohë të mëvonshme.

6. PAGESAT

6.1 Njoftimi i pagesës

Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike para çdo date të pagesës së interesit, sipas rastit, Datës së shlyerjes së detyrueshme, Huadhënësi do të njoftojë Huamarrësin në lidhje me ato shumë që duhet të paguhet nga Huamarrësi për Huadhënësin në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me principalin, interesin dhe tarifën e angazhimit, me kusht që pamundësia për dhënien e këtij njoftimi të mos lehtësojë Huamarrësin nga detyrimi i tij për të kryer pagesa të këtyre shumave të lartpërmendura, kur bëhen të kërkueshme.

Njoftimi përcakton gjithashtu për secilën pagesë që duhet të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, shumën e saktë dhe qëllimin e pagesës (ndarja e shumave të kërkueshme dhe të pagueshme të njoftuara nga Huadhënësi) dhe Huamarrësi kryen pagesën në mënyrën e sugjeruar dhe konfirmon me shkrim aplikimin e fondeve. Huamarrësi këshillon Huadhënësin me shkrim për qëllimin e pagesës (ndarja e fondeve) për çdo shumë të paguar nga Huadhënësi. Nëse nuk merret ndonjë informacion i tillë, zbatohet seksioni 6.6.

Nëse një shumë e caktuar debitohet dhe/ose kreditohet në Llogarinë e Huas dhe/ose në ndonjë llogari tjetër që mund të hapet në lidhje me këtë Marrëveshjeje në çdo kohë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike para datës së pagesës së interesit, interesi ose çdo shumë tjetër e kërkueshme në lidhje me këtë datë të pagesës së interesit do të mbartet dhe do të bëhet i kërkueshëm dhe i pagueshëm ndaj Huadhënësit në datën e ardhshme pasuese të pagesës së interesit, përkatësisht do të (në rastin e shumave të kredituara) rillogaritët në datën e ardhshme pasuese të pagesës së interesit.

6.2 Mënyra e pagesës

Në çdo datë të pagesës së interesit, datë të shlyerjes së detyrueshme ose në çdo datë tjetër të kërkueshme për pagesën e çdo shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit, Huamarrësi do të kryejë pagesën e shumave dhe monedhës së kërkueshme në këtë datë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje në Vjenë, në vlerë në datën e kërkueshme përkatëse.

Të gjitha pagesat e shumave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje nga Huamarrësi për Huadhënësin do të bëhen në Vjenë në euro lirisht të konvertueshme dhe të transferueshme.

6.3 Heqja dorë nga kompensimi ose kundërpada

Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë kompensimi ose kundërpadie që mund të ketë në lidhje me çdo shumë të detyrueshme kundërt Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe bie dakord që nuk do të mbajë

pagesë, për çfarëdolloj arsyeje, të ndonjë shume të kërkueshme për t'u paguar. Në veçanti, Huamarrësi nuk do të mbajë pagesa të shumave të detyrueshme për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje mbi bazën e një padie, të drejte padie, të drejte të ligjshme ose kërkesë kundër Eksportuesit të Projektit ose furnizuesve të tjerë në lidhje me Projektin.

6.4 Pagesa të lira nga mbajtja e taksave dhe detyrime të tjera

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen pa kompensim ose kundërpadi dhe do të jenë të lira dhe pa zbritje për ose në llogari të çdo takse, tatimi, shume të zbritur ose të mbajtur ose tarifa të tjera të tashme ose të ardhshme të çdo lloji natyre të Republikës së Shqipërisë, nëse Huamarrësit nuk i kërkohej me ligj ta bëjë këtë zbritje. Nëse kërkohej me ligj, shumë e kërkueshme nga Huamarrësi në lidhje me këtë pagesë do të rritet në masën e nevojshme për të garantuar që pas kësaj zbritjeje të taksave, tatimeve, shumave të zbritura, të mbajtura ose tarifave të tjera, Huadhënësi të marrë në datën e kërkuar për këtë pagesë një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë nëse kjo zbritje e taksave, tatimeve, shumave të zbritura, të mbajtura ose tarifave të tjera nuk do të ishte kërkuar. Huamarrësi do t'i japë menjëherë Huadhënësit fatura, vërtetime ose dëshmi të tjera që provojnë shumën (nëse ka) e paguara ose të pagueshme në lidhje me çdo shumë të lartpërmendur të zbritur ose të mbajtur.

6.5. Kostot e rritura

Nëse rezultati:

- një ndryshimi në, ose prezantimit të një ligji, rregulloreje ose kërkesë rregullatore ose një ndryshimi në interpretimin ose zbatimin e tyre; ose

- përmbushjes nga Huadhënësi të çdo udhëzimi, kërkesë ose detyrimi (pavarësisht nëse e ka fuqinë e ligjit apo jo) të ndonjë banke qendrore, autoriteti monetar, rregullator ose autoriteti tjetër,

(duke përfshirë, në çdo rast, pa kufizim, ato që lidhen me përshtatshmërinë e kapitalit, likuiditetin, asetet rezervë dhe depozitat e veçanta) është:

- a) të rrisë koston ose të vendosë kosto shtesë për Huadhënësin për vënien ose ruajtjen në dispozicion të angazhimit të tij ose ruajtjen ose financimin e huas; dhe/ose

- b) të reduktojë shumën e pagueshme ose kthimin real për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

- c) të reduktojë normën e kthimit të Huadhënësit mbi kapitalin e tij të përgjithshëm për shkak të një ndryshimi në mënyrën në të cilën kërkohej për të alokuar burimet e kapitalit për detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

- d) të kërkojë Huadhënësit të kryejë një pagesë ose të heqë dorë nga një kthim mbi, ose të llogaritur ndaj çdo

shume të arkëtuar ose të arkëtueshme nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje,

atëherë Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit sipas kërkesës çdo kosto të tillë, ulje, pagesë ose heqje dorë nga një fitim.

Çdo vërtetim i Huadhënësit në lidhje me këtë kosto, ulje, pagesë ose heqje dorë nga një fitim, në mungesë të një gabimi të dukshëm, do të jetë provë përfundimtare dhe detyruese për Huamarrësin.

Për qëllimet e kësaj dispozite Huadhënësi, në mirëbesim, mund të alokojë ose shpërndajë kostot dhe/ose humbjet mes asetëve dhe detyrimeve të tij (ose ndonjë kategorie të tyre) mbi bazën që e konsideron të përshtatshme.

6.6 Ndarja e pagesave

Të gjitha pagesat e marra nga Huadhënësi prej Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç kur Huadhënësi ndryshon urdhrin e zbatimit) do të zbatohen nga Huadhënësi kundrejt pagesës së shumave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje në rendin e mëposhtëm, dhe Huamarrësi bie dakord për zbatimin e këtyre pagesave në këtë rend (dhe për çdo ndryshim të tyre nga Huadhënësi):

a) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.2 dhe 4.3 (Tarifa e menaxhimit dhe shpenzimet);

b) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.4 (Primi i garancisë së OeKB-së);

c) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.1 (Tarifa e angazhimit);

d) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.3 (Kamatëvonesa);

e) shumat e prapambetura sipas seksionit 3.1 (Interesi);

f) shumat e prapambetura sipas seksionit 5.1 (Shlyerja e detyrueshme);

g) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.1 (Interesi);

h) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.1 (Shlyerja e detyrueshme);

i) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.2 (Parapagimi opsional).

Huadhënësi do të informojë Huamarrësin në lidhje me çdo aplikim të fondeve. Shumat e prapambetura shlyhen para shumave të kërkueshme. Çdo udhëzim për të kundërtën i dhënë Huamarrësit nuk merret në konsideratë.

Huamarrësi pranon që në bazë të garancisë që OeKB-ja ka rezervuar kundrejt Huadhënësit të drejtën për të ndryshuar ndarjen e pagesave të përcaktuara më sipër. Në një rast të tillë Huadhënësi do të informojë menjëherë Huamarrësin me shkrim dhe Huamarrësi do të pranojë caktimin e OeKB-së dhe do të marrë përsipër të shlyejë Huan dhe çdo shumë tjetër të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje të njoftuar në atë kohë (duke përfshirë një llogaritje të hollësishme) nga Huadhënësi për Huamarrësin.

7. KUSHTET PARAPRAKE

Kjo Shumë Kredie do të vihet në dispozicion për Huamarrësin në datën **(data e mbylljes)** kur Huamarrësi njoftohet nga Huadhënësi se kushtet e mëposhtme janë përmbushur në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin:

(i) Huadhënësi do të këtë marrë:

a) një kopje të Marrëveshjes së Blerjes të pranueshme në formë dhe të pranueshme për Huadhënësin së bashku me një vërtetim nga Eksportuesi i Projektit në një datë jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike para datës së mbylljes, me efektin që Marrëveshja e Blerjes në formën e paraqitur Huadhënësit është në fuqi dhe efekt të plotë (aneksi 6);

b) një opinion të Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë të pranueshëm për Huadhënësin me atë përmbajtje që Huadhënësi mund të kërkojë (sipas aneksit 5), së bashku me kopje të certifikuar të çdo miratimi ose autorizimi të përmendur në këtë opinion;

c) një kopje të vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që miraton në parim këtë Marrëveshje;

d) një plotfuqi të lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë që autorizon një person ose persona të caktuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera të cilat duhet të nënshkruhen dhe/ose dërgohen në lidhje me këtë Marrëveshje;

e) një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje të nënshkruar sipas rregullave nga një person ose persona të autorizuar me plotfuqinë e përmendur në paragrafin "d" më sipër;

f) modele firmash të vërtetuara të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet t'i jepen Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit;

g) modele firmash të vërtetuara të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet t'i jepen Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Blerësit të Projektit;

h) një emërim të një personi kontakti për Huamarrësin në Republikën e Austrisë për Marrëveshjen (aneksi 7);

i) çdo dokument, provë ose autorizim tjetër që Huadhënësi mund të kërkojë, me qëllim që të bëjë këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara nën të, një marrëveshje ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme.

ii) Huadhënësi do të këtë marrë:

a) garancinë e lëshuar nga OeKB për dhe në emër të Republikës së Austrisë, në pajtim me Ligjin e Promovimit të Eksportit të vitit 1981, të ndryshuar, termat dhe kushtet e të cilit mund të përmbushen nga Huadhënësi;

b) një marrëveshje rifinancimi me OeKB-në për Huan;

c) një marrëveshje plotësuese me Eksportuesin e Projektit dhe miratimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet e Huadhënësit.

iii) Çdo kusht plotësues (nëse ka) të kërkuar në garancinë e Republikës së Austrisë të lëshuar nga OeKB-ja.

Me përmbushjen e të gjitha kushteve të lartpërmendura, Huadhënësi do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë qëllim. Nëse këto kushte nuk do të jenë përmbushur brenda periudhës së mbylljes të përcaktuar në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje, pa cenuar detyrimin e Huamarrësit sipas seksionit 4.2, kjo Marrëveshje nuk do të jetë më detyruese për palët.

Secili prej këtyre dokumenteve dhe njoftimeve do të jetë në gjuhën angleze ose gjermane. Nëse nuk është në gjuhën angleze ose gjermane, një përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze i bashkëlidhet dokumentit të lartpërmendur.

Kushtet në seksionin 7 (kushtet paraprake) janë vendosur vetëm për të mirën e Huadhënësit dhe mund të hiqen ose të shtyhen nga Huadhënësi në tërësi apo pjesërisht, dhe me ose pa kushte.

8. RASTET E MOSPLOTËSIMIT TË DETYRIMEVE

8.1 Rastet e mosplotësimit të detyrimeve

Secili prej rasteve të mëposhtme përbën një rast të mosplotësimit të detyrimeve:

a) ka pamundësi pagese nga Huamarrësi, për më shumë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike, të ndonjë principal, interesi ose shume tjetër të kërkueshme në lidhje me Huan; ose

b) Huamarrësi është i paaftë për të përmbushur ose respektuar siç duhet kushte ose angazhime në përmbajtje të kësaj Marrëveshjeje, të ndryshme nga pagesa e principalit, interesi ose shuma të tjera për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë kalendarike nga data më e hershme në të cilën Huamarrësi vihet në dijeni të pamundësisë së pagesës dhe data në të cilën njoftimi me shkrim për këtë pamundësi që kërkon nga Huamarrësi rregullimin e kësaj pamundësie, i është i dhënë më parë Huamarrësit nga Huadhënësi; ose

c) çdo garanci ose angazhim të ndërmarrë nga Huamarrësi në lidhje me këtë Marrëveshje do të rezultojë të ketë qenë e pasaktë në aspekte materiale në kohën kur është ndërmarrë; ose

d) Huamarrësi do të jetë në mosplotësim të pagesës ose përmbushjes së një detyrimi në lidhje me paratë e marra hua të ndryshme nga Huaja (duke përfshirë në çdo rast një detyrim sipas një garancie); ose

e) çdo autorizim, pëlqim, regjistrim ose aprovim (zyrtar apo tjetër) të kërkuara për vlefshmërinë, zbatueshmërinë ose ligjshmërinë e kësaj Marrëveshjeje

ose Huaje ose ekzekutimi i të cilave është tërhequr ose për ndonjë arsye pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë; ose

f) Republika e Shqipërisë shpall një moratorium të përgjithshëm për detyrimet e pagesës ndaj kreditorëve të saj; ose

g) çdo rast që ka, në diskrecionin e arsyeshëm të Huadhënësit, ndikim negativ material në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

(h) garancia e Republikës së Austrisë e lëshuar nga OeKB ose ndonjë prej dispozitave të saj është anuluar, ka përfunduar ose ka pushuar së qeni në fuqi dhe efekt ose ka pushuar së dhëni garancinë e synuar ose bëhet e paligjshme ose shpallet e pavlefshme për arsye, raste ose rrethana që mund t'i atribuohen sferës së Huamarrësit.

8.2 Masat për rastet e mosplotësimit të detyrimeve

Nëse ka ndodhur një rast i mosplotësimit të detyrimeve dhe në çdo kohë më pas, të gjitha masat e mëposhtme që mund të merren nga Huadhënësi do të jenë të vazhdueshme:

a) Huadhënësi, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të shpallë principalin dhe interesin e shtuar në lidhje me Huan dhe të gjitha shumat e tjera të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, si menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme, pas së cilit do të bëhen menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme, pa deklaram, kërkesë, kundërshtim ose njoftim tjetër të çdo lloji;

b) Huadhënësi, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të shpallë të përfunduar Shumën e Kredisë, pas të cilës detyrimi i Huadhënësit për të realizuar dhe vazhduar Huan sipas kësaj Marrëveshjeje, do të përfundojë menjëherë; dhe

c) çdo masë tjetër që Huadhënësi mund të vendosë të marrë, sipas diskrecionit të tij absolut.

Huamarrësi bie dakord t'i paguajë Huadhënësit, sipas kërkesës, të gjitha humbjet, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet që Huadhënësi mund të ketë si pasojë e mosplotësimit të detyrimeve (duke përfshirë por pa u kufizuar në ndonjë interes të paguar nga Huadhënësi për huadhënësit e fondeve të marra hua nga ai për të ruajtur shumat të vonuara). Një vërtetim nga një nëpunës i autorizuar rregullisht i Huadhënësit që përcakton shumën e këtyre humbjeve, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet dhe bazën e llogaritjes së tyre, kur i paraqiten Huamarrësit (përveç ndonjë gabimi të dukshëm) do të jenë prova përfundimtare të sasisë së këtyre humbjeve, shpenzimeve dhe detyrimeve, me kusht që ky vërtetim të mbështetet nga dokumente që japin të dhëna për këto humbje, shpenzime dhe detyrime dhe këto vërtetime do të mbështeten nga dokumente të përshtatshme.

Huamarrësi, sapo të vihet në dijeni për këtë, do t'i japë njoftim me shkrim Huadhënësit për:

- a) çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve; ose
- b) çdo kusht, rast ose veprim që, me dhënien e njoftimit ose kalimin e kohës ose të dyjave, ose përmbushjen e ndonjë kushti, mund të çonte ose përbënte një rast të mosplotësimit të detyrimeve.

9. GARANCITË DHE ANGAZHIMET

9.1 Garancitë

Me qëllim inkurajimin e Huadhënësit për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të përfituar dhe mbajtur Huan e parashikuar në këtë Marrëveshje, Huamarrësi jep garancitë e mëposhtme në datën e pranimit:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë autorizohet të veprojë në emër dhe për Republikën e Shqipërisë dhe të vendosë Republikën e Shqipërisë para detyrimit ligjor. Si pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të pakufizuara dhe të pakushtëzuara të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të paditet në emër të saj në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Huamarrësi nuk është në mosplotësim të ndonjë prej detyrimeve të tij të pagesës dhe nuk ka ndodhur ose nuk po vazhdon asnjë rast i mosplotësimit të detyrimeve, ose

c) Huamarrësi ka autoritetin për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të marrë hua sipas saj dhe për të nënshkruar, dërguar dhe përmbushur këtë Marrëveshje dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të pranuar kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje dhe për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje që përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Huamarrësit, të zbatueshëm në pajtim me kushtet e saj; ose

d) Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të shkelë dispozitat e ndonjë ligji ose rregulloreje të zbatueshme për Huamarrësin ose ndonjë marrëveshjeje, kontrate ose angazhimi tjetër në të cilën Huamarrësi është palë ose që është detyruese për të ose asetet e tij; ose

e) Të gjitha autorizimet, miratimet, regjistrimet ose aprovimet (zyrtare ose të tjera) të nevojshme në lidhje me nënshkrimin, dorëzimin, përmbushjen, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje janë marrë ose realizuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë.

Garancitë e paraqitura më sipër do të vazhdojnë edhe pas ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të konsiderohen të përsëritura në çdo datë të Huamarrjes dhe në çdo datë të pagesës së interesit.

9.2 Angazhimet

Huamarrësi merr përsipër dhe angazhohet me dhe për Huadhënësin si më poshtë:

a) Të dhënat:

Huamarrësi do të marrë masa:

1) Që: (i) Blerësi i Projektit të mbajë të dhëna të mjaftueshme për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga Huaja; (ii) Blerësi i Projektit informon në lidhje me përdorimin e tyre në Projekt; dhe (iii) Blerësi i Projektit regjistron progresin e Projektit, duke përfshirë koston e tij;

2. Që përfaqësuesit e Huadhënësit të lejohen të inspektojnë Projektin, angazhimin e Blerësit të Projektit, mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së Blerjes dhe çdo të dhënë dhe dokument tjetër;

3. Për të informuar Huadhënësin, ose të marrë masa që t'i dërgohet Huadhënësit i gjithë informacioni që Huadhënësi kërkon në lidhje me shpenzimet e Huas, Projektin dhe mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së Blerjes.

b) Njëvlershmëria dhe pengu negativ

Detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen të paktën *pari passu* dhe njëloj me të gjitha detyrimet e tjera të papaguara, të pasiguruara dhe të pavarura të Huamarrësit. Nga data e pranimit dhe për sa kohë që një pjesë e Huas do të mbetet e papaguar, Huamarrësi nuk do të krijojë ose bjerë dakord për të krijuar ndonjë hipotekë, detyrim, peng, barrë ose interes tjetër garancie mbi të gjithë ose një pjesë të aseteve të tij për të siguruar detyrime ose garanci të ndonjë detyrimi, nëse Huaja nuk sigurohet në mënyrë të barabartë dhe përpjesëtimore, të pranueshme për Huadhënësin.

c) Ndryshimi i Marrëveshjes së Blerjes

Huamarrësi nuk do të bëjë, lejojë ose miratojë ndonjë amendim, ndryshim, modifikim ose përfundim të (përveçse për prishjen e miratuar për shkak të një rezultati negativ të procesit të vlerësimit) Marrëveshjes së Blerjes pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

10. LIGJI RREGULLUES DHE MOSMARRËVESHJET

a) Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës së Austrisë.

b) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin mbi këtë Marrëveshje, duke përfshirë lidhjen e saj, vlefshmërinë dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas kësaj Marrëveshjeje, zgjidhen përfundimisht nga tre arbitra, sipas Rregullave të Pajtitimit dhe Arbitrazhit, në atë kohë në fuqi, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

c) Vendi i arbitrazhit është Parisi. Gjuha që do të përdoret në procedimet e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

d) Vendimi i arbitrazhit përcakton përgjegjësinë e palëve për kostot e shkaktuara nga palët.

e) Arbitrat do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të kryer procedimet dhe për të përgatitur vendimin e tyre, në mënyrë që ta bëjnë të zbatueshëm sipas ligjit.

f) Gjykimi për vendimin mund të zhvillohet në çdo gjykatë që ka juridiksion ose në atë gjykatë mund të

bëhet kërkesë për një pranim gjyqësor të vendimit dhe urdhër ekzekutimi, sipas rastit.

g) Nëse Huadhënësi merr masa ligjore (duke përfshirë padinë, arbitrazhin, sekuestrimin, ekzekutimin ose masa të tjera zbatuese ose mbrojtëse) kundër Huamarrësit në lidhje me ndonjë çështje që lind sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që mund të ketë Huamarrësi.

Përfshimisht, Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti mbi ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi, në lidhje me:

i) “ambientet e tashme ose të ardhshme të misionit” siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, të nënshkruar në 1961, “ambientet e tashme ose të ardhshme konsullore”, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, të nënshkruar në 1963 ose të përdorur ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

ii) çdo pasuri të paluajtshme që përmendet në nenin 3, paragrafët 1-3, të ligjit shqiptar nr. 8743 të datës 22. 2. 2001 “Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore”;

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë të kërkueshme në momentin e ekzekutimit, që është caktuar për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas të drejtës publike ndërkombëtare.

Huamarrësi e cakton Ambasadën e Republikës së Shqipërisë si personin e saj të kontaktit në Vjenë (aneksi 7).

11. TË PËRGJITHSHME

11.1 Njoftimet

Të gjitha njoftimet, shkresat, kërkesat dhe komunikimet e tjera do të jenë të vlefshme në rast njoftimi me shkrim me letër rekomande kur merret, ose në rast të njoftimit me faks, kur merret nga pala për të cilën ky njoftim, kjo shkresë, kërkesë ose komunikim tjetër kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, drejtuar Huamarrësit ose Huadhënësit përkatësisht në adresat e tyre të përcaktuara në aneksin 1 ose në një adresë tjetër që njëri prej tyre mund të caktojë më pas me shkrim për tjetrin, në pajtim me këtë seksion 11.1.

11.2 Titujt përshkrues

Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk përkufizojnë apo kufizojnë dispozitat e saj.

11.3 Heqjet dorë, mjetet mbrojtëse kumulative

Asnjë pamundësi ose vonesë nga ana e Huadhënësit në ushtrimin e një të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Marrëveshjeje dhe asnjë moment mirëkuptimi ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit nuk operon si heqje dorë nga to; një ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të përjashtojë një ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e një të

drejte, kompetence ose privilegji tjetër. Të drejtat dhe mjetet ligjore në këtë marrëveshje të parashikuara shprehimisht janë kumulative dhe nuk janë ekskluzive për ndonjë të drejtë ose mjet ligjor që Huadhënësi do të kishte ndryshe. Asnjë njoftim ose kërkesë ndaj Huamarrësit në ndonjë rast nuk autorizon Huamarrësin për njoftim ose kërkesë tjetër ose të mëtejshme në lidhje me të njëjtat rrethana ose nuk përbën heqje dorë nga të drejtat e Huadhënësit për ndonjë veprim tjetër ose të mëtejshëm në lidhje me këto rrethana, pa njoftim ose kërkesë.

11.4 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje çmohet nga një gjykatë ose organ tjetër kompetent gjyqësor, si e pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera të saj nuk do të cenohet ose dëmtohet dhe palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të rishikuar dispozitën e pavlefshme, në mënyrë që ta bëjnë të zbatueshme në pajtim me qëllimin e shprehur në të.

11.5 Transferimi

Huamarrësi nuk mund të caktojë ose transferojë të gjithë ose një pjesë të të drejtave dhe detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

Huadhënësi mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje: i) pa pëlqimin e Huamarrësit, nëse drejtëmarrësi është OeKB ose (në rast vetëm të mosplotësimit të detyrimeve) çdo bankë ose institucion tjetër financiar; dhe ii) me pëlqimin paraprak me shkrim të Huamarrësit, që nuk do të ndalohej në mënyrë të paarsyeshme, te ndonjë përfitues tjetër.

11.6 Konfidencialiteti

Me anë të kësaj Marrëveshjeje Huamarrësi bie dakord që Huadhënësi të ketë të drejtën për të paraqitur në një mënyrë që është e zakonshme nga bankat, të gjithë informacionin që ai merr në lidhje me këtë marrëveshje ose marrëdhënien e tij të punës me Huamarrësin - veçanërisht në interes të një mbrojtjeje të arsyeshme të kreditorëve - për bankat, institucionet e përbashkëta të bankave ose organizatat e përzgjedhura për mbrojtjen e kreditorëve.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi bie më tej dakord që Huadhënësi të ketë të drejtën për të dhënë informacion që rezulton nga kjo Marrëveshje ose nga marrëdhënia e punës së Huadhënësit me Huamarrësin për personat ose shoqëritë e mëposhtme:

- a) çdo anëtar të grupit të shoqërive të Huadhënësit,
- b) një përfitues i mundshëm që i transferohen të drejtat ose një personi apo shoqërie që mund të propozojë hyrjen në marrëdhënie kontraktuale me Huadhënësin në lidhje me këtë Marrëveshje,
- c) OeKB-në dhe Republikën e Austrisë, dhe
- d) çdo person, autoritet ose subjekt tjetër për të cilin Huadhënësit i kërkohet të japë këtë informacion sipas ndonjë ligji ose urdhri gjyqësor ose organi tjetër gjyqësor

ose organi rregullator, udhëzimet e të cilit duhet të përmbushen nga Huadhënësi.

11.7 Ndryshimet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje nuk mund të modifikohet ose ndryshohet përveçse me instrumente me shkrim.

12. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga palët dhe miratimin nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe botimin në gazetën zyrtare shqiptare të quajtur Fletore Zyrtare.

Në dëshmi të kësaj, palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e shkruar më parë më sipër në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe versionin në gjuhën angleze do të jetë detyrues dhe do të ketë përparësi mbi përkthimet.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë
si Huamarrës
(përfaqësuar nga Ministria e Financave)
UniCredit Bank Austria AG si Huadhënës

ANEKSI 1 PALËT

HUAMARRËSI

Emri: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës (përfaqësuar nga Ministria e Financave)

Adresa: Ministria e Financave

Bul. Dëshmorët e Kombit, nr. 1

Tiranë/Shqipëri

Tel. (355 4) 222 84 05

Faks: (355 4) 222 84 94

Në vëmendje të: I nderuari Z. Ministër i Financave

HUADHËNËSI

Emri: UniCredit Bank Austria AG

Adresa: Schottengasse 6-8, 1010 Vienna

Tel. +43 (0)5 05 05-56939

Faks: +43 (0)5 05 05-8956939

Departamenti përgjegjës: 8243 Structured Trade & Export Finance

Në vëmendje të: Znj. Jaana Novak

ANEKSI 2

1. Projekti:

“Modernizimi i sistemit arsimor -Shqipëri - arsimimi elektronik “

2. Marrëveshja e Blerjes:

Është Marrëveshja e Blerësit (Marrëveshja e Blerësit) nr. ALB 2012 Arsimimi-elektronik datë 3 maj 2013 në shumën prej 2,500,000.00 euro dhe ndryshimi i parë (Amendamenti 1) i Marrëveshjes së Blerësit datë 26 maj 2014, në vlerën prej 1,000,000.00 euro, lidhur

ndërmjet BIT Media Project Exporter e-Solutions GmbH (referuar këtu “Huadhënësi”), dhe Blerësi i Projektit, Ministria e Arsimit dhe Sporteve (referuar këtu “Huamarrësi”), në vlerën totale të 3,500,000.00 euro në lidhje me Projektin.

3. Blerësi i Projektit:

Është Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Tiranë, Republika e Shqipërisë (e njohur më parë si Ministria e Arsimit dhe Shkencës).

4. Eksportuesi i Projektit:

Është BIT Media Project Exporter e-Solutions GmbH (njohur më parë si BIT Media e-Learning Solution GmbH & Co KG), Graz, Austri.

ANEKSI 3

1. Shuma e Kredisë (seksioni 2.2).

Një shumë që nuk kalon 3,500,000 (tre milionë e pesëqind mijë) euro.

2. Periudha e disponueshmërisë (seksioni 2.2)

Nga data e mbylljes (sipas përcaktimit në seksionin 7) deri në ditën që bie 18 muaj pas datës së mbylljes, por që mbaron jo më vonë se (31 maj 2016).

3. Interesi (seksioni 3.1)

0.00 për qind në vit.

4. Kamatëvonesa (seksioni 3.3)

3 muaj EURIBOR plus një marzh prej 2% në vit.

5. Tarifa e angazhimit (seksioni 4.1)

0,5 % në vit (zero pikë pesë për qind në vit)

6. Tarifa e menaxhimit (seksioni 4.2)

0,5 % (zero pikë pesë për qind) e pandryshueshme ndaj Shumës së Kredisë.

7. Primi i garancisë (seksioni 4.4)

i) Primi i garancisë së OeKB-së që paguhet në fillim EUR 13,125.00 (tregues i vetëm)

Shuma përfundimtare do të përcaktohet nga OeKB-ja pas lëshimit të garancisë fillestare. Nëse shuma përfundimtare ndryshon nga shuma e treguar, Huamarrësi do të paguajë diferencën (nëse ka) brenda 30 ditëve kalendarike pasi të jetë njoftuar për të nga Huadhënësi.

ii) Primi i Garancisë së OeKB-së i pagueshëm si marzh

1.00 për qind në vit (tregues i vetëm)

Sipas OeKB-së, norma e mësipërme mbështetet nga një grant shtesë, që është afërsisht 253,750.00 euro nga Ministria Federale Austriake e Financave. Norma dhe granti përfundimtar do të përcaktohen nga OeKB-ja pas lëshimit të garancisë fillestare.

8. Tarifa e administrimit të OeKB-së

1,440.00 euro në lidhje me sigurimin e Kredisë së Eksportit.

9. Datat e detyrueshme të shlyerjes (seksioni 5.1)

Shlyerja duhet të realizohet deri në 19 kështe të barabarta gjashtëmujore të njëpasnjëshme, ku i pari

është i kërkueshëm 72 muaj pas datës së përkohshme të pranimit (nëse kjo datë është shumë herët) jo më vonë se 90 muaj pas datës së mbylljes, në çdo rast kësti i parë i shlyerjes do të jetë data 31 maj 2022 si afati i fundit.

10. Shuma opsionale e parapagimit (seksioni 5.2)
500,000 euro

11. Periudha e mbylljes (seksioni 7)

Një periudhë që fillon në datën e pranimit dhe jo më vonë se deri gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike pas datës së pranimit.

ANEKSI 4 PROCEDURA E PAGESËS

Huamarrësi autorizon Huadhënësin në mënyrë të parevokueshme që të paguajë Eksportuesin e Projektit deri në maksimumin e përgjithshëm të shumës së Kredisë të përmendur në aneksin 3, e cila është 3,500,000.00, kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme pranë Huadhënësit:

A) Bazuar në Marrëveshjen e Blerjes me vlerën prej 2,500,000.00 euro

1. Pagesa e parë (paradhënia)

30% (tridhjetë për qind) e shumës së Marrëveshjes së Blerjes, që është 750,000.00 euro (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) janë të pagueshme si paradhënie, menjëherë pas paraqitjes së:

- Kopjes së Garancisë së Parapagimit të lëshuar nga një bankë austriake në një shumë prej 30% të Marrëveshjes së Blerjes.

- Kopjes së detyrimit të performancës të lëshuar nga një bankë austriake në një shumë prej 10% të Marrëveshjes së Blerjes.

- Kopjes së faturës tregtare të Eksportuesit të Projektit.

2. Pagesa dytë

20% (njëzet për qind) të shumës së Marrëveshjes së Blerjes, që është 500,000.00 (pesë qind mijë) euro paguhen pas dorëzimit të infrastrukturës vepruese dhe pas instalimit të produktit, vendosjen e programit qendror portal arsimor pas paraqitjes së:

- Kopjes së protokollit të pranimit miratuar nga Blerësi i Projektit në përputhje me seksionin 8.1. të Marrëveshjes së Blerjes.

- Kopjes së faturës tregtare të Eksportuesit të Projektit.

3. Pagesa e tretë

40% (dyzet për qind) të shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 1,000,000.00 euro (një milion euro) paguhen pas instalimit të produktit, vendosjen e programit për kurset mësimore elektronike ICT (20%) dhe sistemin e autorizuar të mësimit elektronik (20%) pas paraqitjes së:

- Kopjes së protokollit të pranimit miratuar nga Blerësi i Projektit në përputhje me seksionin 8.1. të Marrëveshjes së Blerjes.

- Kopjes së faturës tregtare të Eksportuesit të Projektit.

4. Pagesa e katërt

5% (pesë për qind) e shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 125,000.00 (njëqind e njëzet e pesë mijë) paguhen pas përfundimit të trajnimeve pas paraqitjes së:

- Kopjes së protokollit të pranimit të trajnimit miratuar nga Blerësi i Projektit në përputhje me nenin 8.1 të Marrëveshjes së Blerjes.

- Kopjes së faturës tregtare të Eksportuesit të Projektit

5. Pagesa e pestë

5% (pesë për qind) e shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 125,000.00 (njëqind e njëzet e pesë mijë) paguhen proporcionalisht në dorëzim pas paraqitjes së:

- Kopjes së protokollit të fundit të pranimit miratuar nga Blerësi i Projektit në përputhje me nenin 8.1. të Marrëveshjes së Blerjes.

- Kopjes së garancisë së parapagimit të lëshuar nga një bankë austriake në një shumë prej 5% të Marrëveshjes së Blerjes.

- Kopjes së faturës tregtare të Eksportuesit të Projektit.

B) Bazuar në amendamentin 1 të Marrëveshjes së Blerjes me vlerë prej 1,000,000.00 euro

6. Pagesa e gjashtë

40% (dyzet për qind) të shumës së amendamentit 1 që është 400,000.00 euro (katërqind mijë) paguhen pas përfundimit të specifikimeve teknike për blerjen e pajisjeve të programeve dhe shërbimeve të nevojshme që kanë lidhje me to (të mos faturohen përpara datës 1 janar 2015) pas paraqitjes së:

- Kopje të specifikimeve teknike përfundimtare për blerjen e pajisjeve të programeve dhe shërbimeve të nevojshme që kanë lidhje me to.

- Letër pranimi e specifikimeve teknike lëshuar nga Blerësi i Projektit

- Kopje e faturës tregtare e Eksportuesit të Projektit.

7. Pagesa e shtatë

60% (gjashtëdhjetë për qind) të shumës së amendamentit 1 që është 600,000.00 euro (gjashtëqind mijë) paguhen pas paraqitjes së:

- Kopje të protokollit përfundimtar të pranimit miratuar nga Blerësi i Projektit në përputhje me nenin 8.1 të Marrëveshjes së Blerjes.

- Kopje të faturës tregtare të Eksportuesit të Projektit.

Huadhënësi ka të drejtë të mbështetet në çdo dokument që besohet prej tyre që është i vërtetë dhe i saktë dhe të jetë nënshkruar ose dërguar nga personi i duhur. Huadhënësi nuk merr përgjegjësi apo detyrim për formën, mjaftueshmërinë, saktësinë, vërtetësinë, falsifikimin ose efektin ligjor të një dokumenti(eve), ose

për kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të parashikuar në dokument(e) ose të vendosura në to; ai nuk merr përgjegjësi ose detyrim as për përshkrimin, sasinë, peshën, cilësinë, gjendjen, paketimin, dorëzimin, vlerën ose ekzistencën e mallrave ose shërbimeve të përfaqësuara nga një dokument(e), apo për mirëbesimin e veprimeve dhe/ose mosveprimeve, paafësinë paguese, përmbushjen ose gjendjen nga dërguesit, transportuesit, paraqitësit, marrësit ose siguruesit e mallrave dhe asnjë person tjetër të tillë.

Lejohen dërgimet e pjesshme dhe paraqitja e pjesshme e dokumenteve.

Huadhënësi i jep Huamarrësit njoftim me shkrim pasi t'i jetë kryer një huamarrje Eksportuesit të Projektit.

Pas kryerjes së një huamarrjeje për Eksportuesin e Projektit, Huadhënësi i dërgon dokumentet përkatëse Huadhënësit me shërbim të veçantë korrieri në vëmendje të.....adresa

ANEKSI 5 OPINION LIGJOR (MODEL)

Nga: Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë:

Për: UniCredit Bank Austria AG

Datë

Unë,, duke vepruar në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, i referohem marrëveshjes së kredisë të eksportit për një hua të butë nr. 232.640 për një shumë prej 3,500,000 euro (Marrëveshja) datë 2014 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës (Huamarrës) dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi (Huadhënësi). Unë nuk shpreh asnjë opinion në lidhje me ligjet e një juridiksioni të ndryshëm nga ai i Republikës së Shqipërisë.

Kam shqyrtuar kopjen e nënshkruar të Marrëveshjes dhe dokumente të tjera që i kam konsideruar të nevojshme dhe të përshtatshme, me qëllim që të mund të jap këtë opinion. Afatet e përcaktuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim, përveç kur Marrëveshja përcakton ndryshe.

Bazuar në sa më sipër, jam i mendimit që:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë dhe të vendosë detyrim ligjor ndaj Republikës së Shqipërisë. Si pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të pakufizuara dhe të pakushtëzuara të Republikës së Shqipërisë. Ndaj Republikës së Shqipërisë mund të ngrihet padi në emrin e saj në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Ministria e Financave autorizohet të veprojë në emër të Huamarrësit dhe të vendosë detyrim ligjor ndaj Huamarrësit. Si pasojë, të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të vlefshme, ligjërish detyruese dhe të zbatueshme të Huamarrësit. Huamarrësi ka autoritet të ngrejë padi dhe të paditet në emrin e tij.

c) Huamarrësi gëzon autoritetin për të lidhur/nënshkruar dhe realizuar Marrëveshjen. Huamarrësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme (qeveritare dhe të tjera) për të autorizuar nënshkrimin e Marrëveshjes sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në të, si dhe ekzekutimin, shpalljen dhe realizimin e Marrëveshjes.

d) Marrëveshja është nënshkruar nga z. në cilësinë e tij si Ministër i Financave të Republikës së Shqipërisë.

e) Marrëveshja e nënshkruar nga Ministri i Financave në emër të Huamarrësit përbën detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin, të zbatueshme në gjykatat e Republikës së Shqipërisë në përputhje me afatet e saj.

f) Personi ose personat që nënshkruajnë Marrëveshjen, të cilët nënshkruajnë apo vërtetojnë çdo dokument tjetër në lidhje me Marrëveshjen, kanë fuqi dhe autoritet të plotë për të vepruar kështu në emër të Huamarrësit.

g) Nënshkrimi dhe realizimi i Marrëveshjes dhe transaksionet e parashikuara në lidhje me të nuk janë në kundërshtim me: i) ligjet, rregulloret ose urdhrat zyrtarë apo gjyqësorë; ii) traktatet, marrëveshjet ose dokumente apo instrumente të tjera në të cilët Huamarrësi dhe/ose Republika e Shqipërisë janë palë ose që janë detyruese mbi të apo mbi asetet e saj përkatëse.

h) Të gjitha autorizimet, aprovimet (përfshirë, nëse është e nevojshme, aprovimet e shkëmbimeve të kontrollit), miratimet, lejet, përjashtimet, të dhënat, regjistrimet, noterizimet dhe kërkesat e tjera të autoriteteve dhe institucioneve qeveritare, gjyqësore dhe publike të nevojshme ose të rekomandueshme në lidhje me ekzekutimin, zbatimin, vlefshmërinë dhe realizimin e Marrëveshjes apo çdo pagese të realizuar sipas saj, janë lëshuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë dhe Huamarrësi gëzon autoritetin e plotë për të kryer të gjitha pagesat sipas Marrëveshjes në euro (euro).

i) Të gjitha shumat që do të paguheshin nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes mund të realizohen të plota dhe pa zbritje për ose për sa i përket çdo tarife, takse, zbritjeje apo detyrimi nga Republika e Shqipërisë, çdo autoriteti tatimor apo nënndarjeje politike. Në rast të një ndalimi/zbritjeje për sa i përket pagesave të interesit sipas Marrëveshjes, detyrimi i Huamarrësit për të paguar shumën shtesë sipas paragrafit 6.4 mbetet i vlefshëm dhe i zbatueshëm.

j) Kjo Marrëveshje është ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe është botuar në gazetën zyrtare shqiptare, që quhet Fletore Zyrtare dhe nuk është e nevojshme ose e këshillueshme të sigurohet ligjshmëria, vlefshmëria, zbatueshmëria ose pranueshmëria si dëshmi të Marrëveshjes, në mënyrë që të arkivohet apo regjistrohet pranë një autoriteti tjetër qeveritar ose agjencie në Republikën e Shqipërisë.

k) Zgjedhja e ligjit të Republikës së Austrisë për të rregulluar Marrëveshjen është një zgjedhje e vlefshme e ligjit dhe do të njihet dhe zbatohet në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil në lidhje me detyrimet e tij sipas Marrëveshjes. Hyrja në fuqi dhe përmbushja e Marrëveshjes nga Huamarrësi përbën veprim juridik privat dhe tregtar. Heqja dorë nga imuniteti në seksionin 10 "g" të Marrëveshjes është e vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin.

l) Nuk është e nevojshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë: i) me qëllim që t'i mundësohet Huadhënësit të zbatojë të drejtat e tij përkatëse sipas Marrëveshjes; ose ii) për shkak të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të Marrëveshjes, që Huadhënësi të licencohet, kualifikohet ose t'i jepet e drejta për të kryer veprimtari biznesi në Republikën e Shqipërisë.

Huadhënësi as është, as do të jetë rezident, banues, as nuk do të kryejë veprimtari biznesi apo t'i nënshtrohet tatimeve në Republikën e Shqipërisë për shkak vetëm të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të Marrëveshjes.

m) Dispozitat e seksionit 10 të Marrëveshjes janë të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë do të njohin çdo vendim dhe/ose vendim arbitrazhi në lidhje me Marrëveshjen si të vlefshëm dhe përfundimtar dhe do t'i zbatojnë këto vendime gjyqësore dhe/ose vendime arbitrazhi.

Një vendim i përcaktuar në euro (euro) do të njihet dhe zbatohet në Republikën e Shqipërisë.

Sipas njohurive të mia, nuk ekziston asnjë procedim gjyqësor, arbitrazhi apo administrativ aktual apo i mbetur pezull ose, që sipas informacionit tonë, do të kryhej ndaj Huamarrësit, që do të kishte rezultuar ose mund të rezultonte në një ndryshim të pafavorshëm material në gjendjen financiare apo korporative të Huamarrësit.

n) Marrëveshja dhe të gjitha dokumentet e tjera nuk përmbajnë ndonjë dispozitë që do të konsiderohet e pazbatueshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

o) Detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes do të renditen në çdo kohë të barasvlershme me të gjitha detyrimet e tjera të Huamarrësit, përveç atyre detyrimeve të parashikuara si të detyrueshme me ligj.

Ky opinion ligjor jepet vetëm në interes të Huadhënësit dhe nuk mund t'i bëhet i ditur ndonjë personi tjetër.

Me respekt

ANEKSI 6

KONFIRMIM QË MARRËVESHJA E BLERJES ËSHTË NË FUQI DHE EFEKT TË PLOTË

(Huadhënësi)

Lënda: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 232.640 për një shumë prej 3,500,000 euro (Marrëveshja) datë2014 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës (Huamarrës) dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi (Huadhënës).

Të nderuar Zotërinj,

Me anë të kësaj shkrese Ju konfirmojmë se Marrëveshja e Blerjes nr. ALB 2012 arsimimi elektronik, e lidhur më 3 janar 2013 ndërmjet AME International GmbH dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë ka hyrë në fuqi më (.....).

Graz,

.....
BIT Media e-Solutions GmbH

ANEKSI 7

PRANIMI I EMËRIMIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT

(Huadhënësi)

Lënda: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 232.640 për një shumë prej 3,500,000 euro (Marrëveshja) datë 201 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës (Huamarrës) dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi (Huadhënës).

Të nderuar Zotërinj,

Si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, pranoj në emrin tim dhe për llogari të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, emërimin si person i autorizuar i Huamarrësit për të shërbyer si person kontakti për dhe në lidhje me këtë Marrëveshje

Adresa time në Vjenë është:

Nëse do të ketë ndryshime në adresën time, do t'Ju njoftoj me shkrim pa vonesë.

Me respekt

.....

Ambasada e

Republikës së Shqipërisë në Austri

vendi, data

LIGJ
Nr. 81/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM PËR HUAN E PARË TË
POLITIKËS SË ZHVILLIMIT PËR FINANCAT
PUBLIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e parë të politikës së zhvillimit për financat publike.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.7.2014

Shpallur me dekreten nr. 8661, datë 31.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Departamenti Ligjor (I ndryshueshëm)

Tekst i negociueshëm

Nightingale Rukuba-Ngaiza

26 mars 2014

NUMRI i huas ____

MARRËVESHJE HUAJE

(HUA E POLITIKËS PËR ZHVILLIMIN PËR
MODERNIZIMIN E SEKTORIT FINANCIAR)
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM DATË _____, 2014

Marrëveshje e datës _____, 2014 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim

dhe Zhvillim (Banka), me qëllim dhënien e financimit në mbështetje të Programit (siç përcaktohet në shtojcën e Marrëveshjes). Banka, ndër të tjera, ka vendosur të japë këtë financim në bazë të: a) hapave që tashmë Huamarrësi i ka ndërmarrë sipas Programit dhe që përshkruhen në seksionin I të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje; dhe b) mbajtja nga ana e Huamarrësit e një kuadri të përshtatshëm të politikave makroekonomike. Për këtë, Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni I

Kushtet e përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveçse nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimin e dhënë në Kushtet e Përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Huaja

2.01. Banka pranon t'i japë hua Huamarrësit, në bazë të termave dhe kushteve të parashtruara ose të referuara në këtë Marrëveshje, shumën prej shtatëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind mijë euro (€72,600,000), shumë e cila mund të konvertohet herë pas herë nëpërmjet Këmbimit të Valutës në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kësaj Marrëveshjeje ("Huaja").

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë shumat e Huas në mbështetje të Programit, në përputhje me seksionin II të skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa fillestare e pagueshme nga Huamarrësi do të jetë sa një e katërta e një për qind (0.25%) të shumës së Huas.

2.04 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo Periudhë Interesi do të jetë me normë të njëjtë sa Norma e Referencës për Valutën e Huas plus Luhatjen e Pandryshueshme; me kusht që, nëse ndodh një Konvertim i së gjithës ose ndonjë pjese të shumës principale të Huas, interesi i pagueshëm nga Huamarrësi gjatë Periudhës së Konvertimit mbi këtë shumë do të përcaktohet në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit IV të Kushteve të Përgjithshme. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse ndonjë shumë e Bilancit të Tërhequr të Huas mbetet pa paguar sipas afatit dhe një mospagim i tillë vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, atëherë interesi i pagueshëm nga Huamarrësi do të llogaritet siç parashikohet në seksionin 3.02 (e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.05 Datat e Pagimit janë 1 mars dhe 1 shtator të çdo viti.

2.06 Principali i Huas do të shlyhet në përputhje me planin e amortizimit të paraqitur në grafikun 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 a) Huamarrësi në çdo kohë mund të kërkojë secilën nga Ndryshimet e mëposhtme të termave të Huas në mënyrë që të lehtësojë administrimin e kujdesshëm të borxhit: i) ndryshimin e Valutës së Huas të së gjithës apo të një pjese të shumës principale të Huas, të disbursuar apo jo, në një Valutë të Miratuar; ii) ndryshim të bazës së normës së interesit të zbatueshme për: A) të gjithë ose ndonjë pjesë të shumës principale të Huas të disbursuar dhe të papaguar nga një Normë e Ndryshueshme në një Normë Fikse, ose anasjelltas; ose B) të gjithë ose ndonjë pjesë të shumës principale të Huas të disbursuar dhe të papaguar nga një Normë e Ndryshueshme e bazuar në një Normë Referencë dhe Luhajtje të Ndryshueshme në një Normë të Ndryshueshme të bazuar në një Normë Reference Fikse dhe Luhajtjen e Ndryshueshme, ose anasjelltas; ose C) të gjithë shumën principale të Huas të disbursuar dhe të pashlyer nga një Normë e Ndryshueshme e bazuar në një Luhajtje të Ndryshueshme në një Normë të Ndryshueshme të bazuar në Luhajtje Fikse.

b) Çdo këmbim i kërkuar sipas paragrafit (a) të këtij seksioni që pranohet nga Banka do të konsiderohet si “Këmbim”, siç përcaktohet në Kushtet e Përgjithshme dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit IV të Kushteve të Përgjithshme dhe Udhëzimeve të Këmbimit Valutor.

2.08 Pa u kufizuar në dispozitat e seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme (i rinumërtuar si i tillë sipas paragrafit 3 të seksionit II të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje dhe në lidhje me Bashkëpunimin dhe Këshillimin), Huamarrësi do t’i sigurojë menjëherë Bankës informacione në lidhje me dispozitat e këtij neni II, siç mund t’i kërkojë Banka herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

Neni III Programi

3.01. Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj Programit dhe zbatimin e tij. Për këtë qëllim, dhe në bazë të seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme:

a) Huamarrësi dhe Banka, herë pas here, me kërkesë të njërit prej palëve, do të shkëmbejnë pikëpamje mbi kuadrin e politikave makroekonomike të Huamarrësit dhe progresin e arritur në përmbushjen e Programit;

b) përpara shkëmbimeve të tilla të pikëpamjeve, Huamarrësi do t’i japë Bankës për shqyrtim dhe komentim një raport mbi progresin e arritur në realizimin e Programit, në detaje të tilla që Banka mund t’i kërkojë në mënyrë të arsyeshme; dhe

c) pa u kufizuar në dispozitat e paragrafëve (a) dhe (b) të këtij seksioni, Huamarrësi do të informojë menjëherë Bankën për çdo situatë që mund të kishte

efekt të kundërt me objektivat e Programit apo ndonjë veprim të ndërmarrë në kuadër të Programit.

Neni IV Mjetet e Bankës

4.01. Rasti Shtesë i Pezullimit konsiston në një situatë të ndodhur që do ta bënte Programin, apo një pjesë thelbësore tij, të pamundur për t’u zbatuar.

Neni V Hyrja në fuqi; zgjidhja

5.01. Kushti Shtesë i Efikasitetit konsiston sa më poshtë, që Banka është e kënaqur me progresin e arritur nga Huamarrësi në zbatimin e Programit dhe me përshtatshmërinë e kuadrit të politikës makroekonomike të Huamarrësit.

5.02. Afati për hyrjen në fuqi është 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni VI Përfaqësuesi; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i tij i Financave.

6.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Faks:

355 42228494

6.03 Adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development
1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Adresa kabllore: Teleks: Faks:

INTBAFRAD 248423(MCI) ose 1-202-477-6391

Washington, D.C. 64145(MCI)

Rënë dakord më _____, _____, në datën
dhe vitin e shkruar më lart.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Nga:

Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Pozicioni: _____

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM

Nga:

Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Pozicioni: _____

SKEDULI 1
VEPRIMET E PROGRAMIT
DISPONUESHMËRIA E SHUMAVE TË HUAS

SEKSIONI I
VEPRIMET SIPAS PROGRAMIT

Veprimet e ndërmarra nga Huamarrësi sipas Programit përfshijnë sa më poshtë:

1. Huamarrësi nëpërmjet Bankës së tij Qendrore ka përshtatur një Kuadër të kuptueshëm Mbikëqyrës të Bazuar në Risk për të rritur mbikëqyrjen efikase të Bankës Qendrore në industrinë bankare.

2. Huamarrësi nëpërmjet Bankës së tij Qendrore ka nxjerrë vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 26.2.2014 i cili, ndër të tjera, urdhëron bankat për të përgatitur dhe miratuar Planet e Rimëkëmbjes për të demonstruar aftësinë e tyre për të operuar gjatë periudhave të stresit financiar.

3. Këshilli i Ministrave i Huamarrësit ka dorëzuar në Parlament Ndryshimet e Ligjit për Sigurimin e Depozitave, i cili, ndër të tjera, përputh veprimet e Autoritetit të Sigurimeve të Depozitave të Shqipërisë me Parimet Thelbësore për Sistemet Efikase të Sigurimit të Depozitave.

4. Këshilli i Ministrave i Huamarrësit ka dorëzuar në Parlament Ndryshimet e Ligjit mbi Tatimin mbi të Ardhurat nr. 8438, datë 28/12/1998, i cili, ndër të tjera, qartëson zbritjen e taksave nga Kreditë me Probleme, në mënyrë që t'i mundësojë bankave që të zhvlerësojnë Kreditë me Probleme në Çështje Gjyqësore të Vonuara.

5. Huamarrësi nëpërmjet Bankës së tij Qendrore ka miratuar Ndryshime të Rregullores mbi Administrimin e Riskut të Kredisë, të cilat, ndër të tjera, u kërkojnë bankave të çregjistrojnë Kreditë me Probleme që kanë qenë në "Kategorinë e Humbjes për një periudhë 3 (tre)-vjeçare".

6. Huamarrësi nëpërmjet Bankës së tij Qendrore ka nxjerrë tre udhëzime, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, udhëzime që kanë të bëjnë me: a) udhëzim për ristrukturimin e kredive për bizneset; b) udhëzim për ristrukturimin e kredive për individët; dhe c) udhëzim për vlerësimin e pasurive të paluajtshme.

7. Huamarrësi nëpërmjet Bankës së tij Qendrore ka nxjerrë një vendim të Këshillit Mbikëqyrës "Administrimi i riskut për ekspozimet madhore të bankave", Këshilli Mbikëqyrës nr. 10, datë 26.2.2014, i cili, ndër të tjera, forcon praktikën e sigurimit të kredive, kthimin e kredive me probleme, vendosmërinë dhe menaxhimin për huamarrësit e mëdhenj siç përcaktohet në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

8. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave e Huamarrësit kanë nxjerrë së bashku një udhëzim "Mbi përcaktimin e tarifave të përmbauesve për shërbimet e siguruar nga përmbauesit gjyqësorë privatë", i cili, ndër

të tjera, siguron stimuj në bazë të tregut për kompensimin e përmbauesve privatë.

9. Këshilli i Ministrave i Huamarrësit ka dorëzuar në Parlament: a) Ligjin mbi sigurimet; b) Ndryshimet e ligjit të AMF-së; c) Ndryshimet e ligjit "Mbi pagat, shpërblymimet dhe strukturën e institucioneve kushtetuese të pavarura dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj"; dhe d) Ndryshimin e ligjit të nëpunësve civilë, për të siguruar pavarësinë financiare dhe operacionale të AMF-së.

10. Huamarrësi nëpërmjet AMF-së ka nxjerrë masa për stabilizimin e tregut, që përfshijnë: a) Një Rregullore mbi Standardet Minimale të Sigurimit Motorik për Detyrimet ndaj Palëve të Treta; dhe b) Një plan me afate të përcaktuara kohore për plotësimin e Fondit të Kompensimit.

SEKSIONI II
DISPONUESHMËRIA E SHUMËS SË HUAS

A. Të Përgjithshme. Huamarrësi mund të tërheqë shumat e Huas në përputhje me dispozitat e këtij seksioni dhe udhëzimeve të tjera që mund të specifikohen nga Banka duke njoftuar Huamarrësin.

B. Disbursimi i Shumave të Huas. Huaja nga e cila Huamarrësi mund të bëjë disbursime të shumave të Huas. Shpërndarja e shumave të Huas për këtë qëllim është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Shpërndarja	Shuma e Huas së Shpërndarë (e shprehur në euro)
Disbursim me një transh të vetëm	72,418,500
Tarifa fillestare	181,500
SHUMA TOTALE	72,600,000

C. Kushti për Çlirimin e Transhit të Disbursuar

Nuk do të bëhet asnjë tërheqje e Këstit të Disbursuar nëse Banka nuk është e kënaqur: a) me Programin që po zbatohet nga Huamarrësi; dhe b) me përshtatshmërinë e kuadrit të politikave makroekonomike të Huamarrësit.

D. Depozitimi i Shumave të Huas. Përveç rasteve kur Banka mund të bjerë dakord për të kundërtën:

1. të gjitha disbursimet nga Llogaria e Huas do të depozitohen nga Banka në një llogari të përcaktuar nga Huamarrësi dhe të pranueshme nga Banka; dhe

2. Huamarrësi do të garantojë që për çdo depozitim të një shume të Huas në këtë llogari, përlllogaritet një shumë ekuivalente në sistemin e menaxhimit të buxhetit të Huamarrësit, në një mënyrë të pranueshme nga Banka.

E. Shpenzime të përjashtuara. Huamarrësi merr përsipër që shumat e Huas nuk do të përdoren për të financuar Shpenzimet e Përjashtuara. Nëse Banka në çdo kohë vendos që një shumë e Huas është përdorur për të bërë një pagesë për një Shpenzim të Përjashtuar, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit të Bankës, do t'i

kthejë Bankës një shumë të barabartë me shumën e një pagese të tillë. Shumat e kthyer Bankës pas një kërkesë të tillë do të anulohen.

F. Data e mbylljes. Data e mbylljes është 30 qershor 2015.

SKEDULI 2

SKEDULI I AMORTIZIMIT

1. Tabela e mëposhtme përcakton Datat e Pagesës së Principalit të Huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të Huas të shlyeshme në çdo Datë të Pagesës së Principalit (Shpërndarja e Kësteve). Nëse shumat e Huas janë tërhequr plotësisht në Datën e parë e Pagimit të Principalit, shuma principale e Huas e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo Datë të Pagimit të Principalit do të vendoset nga Banka duke shumëzuar: a) Balancën e Disbursuar të Huas në Datën e parë e Pagimit të Principalit; me b) Shpërndarjen e Këstit për çdo Datë Pagimi Principali, ku kjo shumë e shlyeshme duhet të përshtatet, sipas nevojës, duke zbritur çdo shumë të referuar në paragrafin 4 të këtij skeduli, ndaj të cilit aplikohet këmbimi i valutës.

Data e Pagesës së Principalit	Shpërndarja e kësteve (e shprehur në përqindje)
Çdo 1 mars dhe 1 shtator Duke filluar më 1 shtator 2021 deri më 1 mars 2036	3.23%
Më 1 shtator 2036	3.1%

2. Nëse shumat e Huas nuk janë disbursuar plotësisht në Datën e parë të Pagimit të Principalit, shuma principale e Huas së shlyeshme nga Huamarrësi në çdo Datë Pagimi Principali do të vendoset si më poshtë:

a) Në masën që çdo shumë e Huas që është disbursuar në Datën e parë të Pagimit të Principalit, Huamarrësi do të shlyejë Balancën e Huas së Disbursuar në atë datë në përputhje me paragrafin 1 të këtij skeduli.

b) Çdo shumë e disbursuar pas Datës së parë të Pagimit të Principalit do të shlyhet në çdo Datë Pagimi Principali që vjen pas datës së një disbursimi të tillë në shuma të vendosura nga Banka duke shumëzuar shumën e çdo disbursimi të tillë me një thyesë, numërori i të cilës është Shpërndarja fillestare e Këstit të specifikuar në tabelën e paragrafit 1 të këtij skeduli për Datën e përmendur të Pagimit të Principalit (Shpërndarja Fillestare e Këstit) dhe emëruesi i të cilës është shuma e të gjithë Shpërndarjeve të mbetura Fillestare të Këstit për Datat e Pagimit të Principalit që vijnë gjatë apo pas një date të tillë, shuma këto të shlyeshme, sipas nevojës, për t'u rregulluar duke zbritur çdo shumë të referuar në paragrafin 4 të këtij skeduli, ndaj të cilit aplikohet këmbimi i valutës.

3.a) Shumat e Huas së disbursuar brenda dy muajve kalendarikë përpara çdo Date Pagimi Principali, vetëm për qëllimet e llogaritjes së shumës principale të 5640

pagueshme në çdo Datë Pagimi Principali, do të trajtohen si të disbursuara dhe të patërhequra në Datën e dytë të Pagimit të Principalit pas datës së disbursimit dhe do të jenë të shlyeshme në çdo Datë Pagimi Principali që fillon me Datën e dytë të Pagimit të Principalit që pason datën e disbursimit.

b) Pavarësisht dispozitave të nënparagrafit (a) të këtij paragrafi, nëse në çdo kohë Banka miraton një sistem faturimi sipas të cilit faturat lëshohen para ose pas datave përkatëse të Pagimit të Principalit, dispozitat e këtij nënparagrafi nuk do të jenë më të zbatueshme për çdo disbursim të bërë pas miratimit të një sistemi të tillë faturimi.

4. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij skeduli, pas një këmbimi valute të së gjithës apo një pjese të Balancës së Huas të Disbursuar në një valutë të miratuar, shuma e konvertuar në këtë mënyrë në valutën e miratuar që është për t'u shlyer në çdo Datë Pagimi Principali që ndodh gjatë periudhës së këmbimit, do të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar këtë shumë në valutën e emërtuar menjëherë përpara këmbimit nëpërmjet: i) kursit të këmbimit që reflekton shumat e principalit në valutën e miratuar të pagueshme nga Banka sipas transaksionit të valutës në kufi në lidhje me këmbimin; ose ii) nëse Banka vendos kështu në përputhje me Udhëzimet e Konvertimit, komponentin e kursit të këmbimit të kursit zyrtar.

5. Nëse Balanca e Huas së Disbursuar është shprehur në më shumë se në një valutë huaje, dispozitat e këtij skeduli do të zbatohen të ndara për çdo shumë të shprehur në secilën valutë huaje, në mënyrë që të paraqitet një skedul i veçantë amortizimi për çdo shumë të tillë.

SHTOJCË SEKSIONI I PËRKUFIZIMET

1. “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare” ose “AMF” është agjencia rregullatore financiare e Huamarrësit, e krijuar dhe që funksionon në zbatim të ligjit nr. 9572 datë 3 korrik 2006 ose pasardhësi i saj ligjor.

2. “Ndryshimet e ligjit mbi sigurimin e depozitave” janë ndryshimet e ligjit nr. 8873 “Ligji mbi sigurimin e depozitave”, datë 29 mars 2002, të cilat u miratuan nga Këshilli i Ministrave më datë 26 mars 2014.

3. “Ndryshimet e ligjit të AMF-së” janë ndryshimet e ligjit nr. 9572, datë 3 korrik 2006, të cilat u miratuan nga Këshilli i Ministrave me datë 19 mars 2014.

4. “Ndryshimet e ligjit për statusin e nëpunësit civil” janë ndryshimet e ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” nr. 152/2013, datë 30 maj 2013, ndryshime të cilat u miratuan nga Këshilli i Ministrave me datë 19 mars 2014.

5. “Ndryshimet e ligjit për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të

institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” janë ndryshimet e ligjit për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligjin nr. 9584 i vitit 2006, të cilat janë miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 19 mars 2014.

6. “Ndryshimet e ligjit për taksat” janë ndryshimet e ligjit nr. 8438, datë 28 dhjetor 1998, të cilat u miratuan nga Këshilli i Ministrave në datën 5 shkurt 2014.

7. “Ligji mbi sigurimet” është akti i propozuar për rregullimin e industrisë së sigurimeve miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 26 mars 2014.

8. “Shoqata Ndërkombëtare e Shoqërive të Sigurimit të Depozitave” është një organizatë jofitimprurëse, e krijuar dhe e cila e bazon aktivitetin e saj në zbatim të nenit 60 të Kodit Civil të Zvicrës.

9. “Këshilli Mbikëqyrës i BSH-së” është organizimi drejtues i BSH-së, përgjegjës për organizimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e veprimeve të kryera nga BSH-ja.

10. “Banka Qendrore” ose “BSH” është Banka e Shqipërisë e krijuar dhe që operon në zbatim të ligjit për Bankën e Shqipërisë nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997, ose pasardhësi i saj ligjor.

11. “Fondi i Kompensimit” është fondi i krijuar në zbatim të ligjit për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të transportit për detyrimet ndaj palëve të treta, ligji nr. 10076, datë 12 shkurt 2009, i cili synon të kompensojë personat e dëmtuar nga drejtuesit e pasiguruar të mjeteve.

12. “Parimet Bazë të Sistemit Efikas të Sigurimit të Depozitave” janë parime të përcaktuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Shoqërive të Sigurimit të Depozitave, me qëllim përmirësimin e efikasitetit të sistemit të sigurimit të depozitave.

13. “Administrimi i Riskut të Kredive” është kuadri i parimeve të menaxhimit të riskut për kredinë në bankat tregtare.

14. “Shpenzimet e Përfshiuara” janë të gjitha shpenzimet:

a) për mallra ose shërbime të dhëna përmes një kontrate, të cilën një institucion financiar kombëtar apo ndërkombëtar apo agjenci, i ndryshëm nga Banka apo Shoqata, ka financuar ose kanë rënë dakord të financojnë, ose që Banka ose Shoqata e kanë financuar ose kanë rënë dakord ta financojnë përmes një huadhënieje, kredie ose granti tjetër;

b) për mallra të përfshira në grupet ose nëngrupet e mëposhtme të Klasifikimit Standard Ndërkombëtar Tregtar (SITC), versioni i ripunuar 3 (SITC, Vers.3), publikuar nga Gazeta Zyrtare e Kombeve të Bashkuara për Statistikat, seria M, nr. 34/Vers.3 (1986) (SITC), ose çdo grup apo nëngrup pasardhës sipas versionit të mëvonshëm të SITC, sipas përcaktimeve të Bankës duke njoftuar Huamarrësin:

Grupi	Nëngrupi	Përshkrimi i artikullit
112		Pije alkoolike
121		Duhan, mbetje të papërpunuara të duhanit
122		Duhan i përpunuar (pavarësisht nëse përmban apo jo zëvendësues të duhanit)
525		Materiale radioaktive ose që kanë lidhje me to
667		Perla, gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar, të përpunuar ose jo
718	718.7	Reaktorë bërthamorë dhe pjesë të tjera të saj; element të karburantit (fishekë), jo të rrezatuar, për reaktorë bërthamorë
728	728.43	Makinë për përpunim të duhanit
897	897.3	Bizhuteri prej ari, argjendi ose prej metaleve të grupit të platinit (më përjashtim të orëve të dorës dhe valixheve të demonstrimit të orëve) dhe materialeve të punuara nga ari dhe argjendi (përfshirë gurët e çmuar)
971		Ari, jo ai monetar (përjashtuar xehërorët dhe koncentratët prej ari)

c) për mallra që përdoren për qëllime ushtarake ose paraushtarake ose konsum luksi;

d) për mallrat e rrezikshme për mjedisin, prodhimi, përdorimi ose importimi i të cilave ndalohej nga legjislacioni i Huamarrësit ose nga marrëveshjet ndërkombëtare, pjesë e të cilave është Huamarrësi, dhe çdo produkt tjetër i përcaktuar si i rrezikshëm për mjedisin, i parashikuar përmes marrëveshjes ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës);

e) llogari të pagesave të ndaluara nëpërmjet vendimit të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara, në zbatim të kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, dhe;

f) në zbatim të përcaktimeve të Bankës për ato që i konsideron si praktika korruptive, mashtruese, të fshehta apo shtrënguese në të cilat janë të përfshirë përfaqësues të Huamarrësit ose të ndonjë përfituesi tjetër të shumës së kredisë, në rastet kur Huamarrësi (ose përfituesi tjetër) nuk kanë marrë në kohën dhe mënyrën e duhur masat, të pranueshme për Bankën, me qëllim trajtimin e praktikave në momentin kur mund të ndodhin.

15. “Kushtet e Përgjithshme” janë “Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Kredi” në datën 12 mars 2012, së bashku me modifikimet e përcaktuara në seksionin II të kësaj shtojce.

16. “Udhëzime për kredi ristrukturimi për bizneset” janë udhëzime të hartuara nga Banka Qendrore e Huamarrësit më 1 nëntor 2013.

17. “Udhëzime për kredi ristrukturimi për individët” janë udhëzime të hartuara nga Banka Qendrore e Huamarrësit në datën 1 nëntor 2013.

18. “Udhëzime për vlerësimin e pasurive të paluajtshme” janë udhëzime të hartuara nga Banka Qendrore e Huamarrësit në datën 1 nëntor 2013

19. “Udhëzim mbi përcaktimin e tarifave të shërbimit përmbarimor për përmbaruesit gjyqësor privatë” janë instruksionet nr. 1665/1, datë 5 mars 2014, të hartuara bashkërisht nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave, me qëllim përcaktimin e llojit dhe shumave të tarifave për shërbimet përmbarimore gjatë periudhës së ekzekutimit detyrues të kolateralit.

20. “Kategoritë e humbjeve” janë kategoritë më të mëdha të humbjeve sipas përcaktimeve të Rregullores së Bankës Qendrore nr. 62, datë 14 shtator 2011.

21. “MF” është Ministria e Financave të Huamarrësit ose pasardhësi i saj ligjor.

22. “MD” është Ministria e Drejtësisë së Huamarrësit ose pasardhësi i saj ligjor.

23. “Kreditë me Probleme” ose “NPL” janë kreditë të cilat janë të klasifikuara në kategoritë e rrezikuara në zbatim të rregullores “Për administrimin e Riskut të Kredisë për Bankat dhe Degët Bankare,” Rregullorja e Bankës Qendrore nr. 62, datë 14 shtator 2011.

24. “Kredi me Probleme në Procese Gjyqësore të Zgjatura” janë NPL-të, të cilat janë ende në proces gjyqësor për zgjidhje të ekzekutimit të kolateralit për një periudhë kohore prej një (1) viti që nga data e dhënies së vendimit gjyqësor.

25. “Program” është programi i veprimeve të ndërmarra, objektivave dhe politikave të caktuara, me qëllim përcaktimin e nxitjes së zhvillimit dhe arritjes së uljes së ndjeshme të varfërisë, siç përcaktohet apo i referohet letresë së datës 20 mars 2014 nga Huamarrësi për Bankën, ku i shpreh angazhimin e Huamarrësit në përmbushjen e Programit, dhe përmes së cilës i kërkon asistencë Bankës të mbështesë Programin gjatë përmbushjes së tij.

26. “Plani i Rimëkëmbjes” është një dokument i përgatitur nga bankat në përgjigje të kërkesës së Bankës Qendrore, i cili vlerëson mundësitë dhe potencialin e rimëkëmbjes së bankave.

27. “Rregullore mbi Standardet e Rezervave Minimale Motorike për Përgjegjësitë ndaj të Tretëve” nënkupton standardet minimale për rezervat likuide për t’u përmbushur nga shoqëritë e sigurimeve në përmbushjen e pretendimeve në Detyrimet Motorike ndaj të tretëve.

28. “Kuadri Mbikëqyrës i Bazuar në Risk” është Manuali i Mbikëqyrjes i Bazuar në Risk (siç përcaktohet më poshtë) dhe Politikat Operacionale të Mbikëqyrjes së Riskut (siç përcaktohet më poshtë), të hartuara nga Huamarrësi me qëllim mbikëqyrjen e industrisë bankare.

29. “Manuali i Mbikëqyrjes i Bazuar në Risk” është manuali i miratuar nga Banka Qendrore në zbatim të

urdhrit nr. 590, datë 27 shkurt 2014, për një vlerësim të përgjithshëm të riskut të bankave.

30. “Politikat Operacionale të Mbikëqyrjes së Riskut” janë politika të Bankës Qendrore të cilat përkufizojnë organizimin, planifikimin dhe realizimin e proceseve të mbikëqyrjes së riskut nga Banka Qendrore, të hartuara nga Këshilli Mbikëqyrës në zbatim të vendimit nr. 9, datë 26 shkurt 2014.

SEKSIONI II

MODIFIKIME TË KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME

Modifikimet e Kushteve të Përgjithshme janë si më poshtë:

1. Fjalja e fundit e paragrafit (a), seksioni 2.03 (lidhur me Aplikimin për Tërheqje) është hequr tërësisht.

2. Seksionet 2.04 (Llogari të Cilësuar) dhe 2.05 (Shpenzime të Pranueshme) janë hequr tërësisht, dhe seksionet vijuese janë rinumërtuar.

3. Seksioni 5.01 (Përmbushja e Përgjithshme e Projektit) dhe 5.09 (Menaxhimi Financiar; Pasqyrat Financiare; Auditet) janë hequr tërësisht, dhe seksionet vijuese në nenin V janë rinumërtuar.

4. Paragrafi (a) i seksionit 5.05 (rinumërtuar në bazë të paragrafit 3 të mësipërm në lidhje me përdorimin e mallrave, punës dhe shërbimeve) është hequr tërësisht.

5. Paragrafi (c) i seksionit 5.06 (rinumërtuar në bazë të paragrafit 3 të mësipërm) është modifikuar si më poshtë:

“Seksioni 5.06. Plani; dokumentacioni; të dhënat

c) Huamarrësi duhet të ruajë të gjitha të dhënat (kontrata, urdhra, fatura, vërtetime dhe dokumente të tjera), të cilët dokumentojnë shpenzimet e kryera përmes kredisë deri në dy vjet pas Datës së Përfundimit. Huamarrësi duhet të mundësojë që përfaqësues të Bankës të shqyrtojnë këto të dhëna.”

6. Paragrafi (c) i seksionit 5.07 (rinumërtuar në vijimësi të paragrafit 3 të mësipërm) është modifikuar si më poshtë:

Seksioni 5.07. Monitorimi dhe vlerësimi i programit

c) Huamarrësi duhet të hartojë, ose të marrë masa për hartimin, dhe t’i mundësojë Bankës, jo më vonë se gjashtë muaj pas Datës së Mbylljes, një raport të kësaj natyre dhe të hollësishëm, sipas kërkesës së arsyeshme të Bankës, për përmbushjen e Programit, performancën e Palëve të Huas dhe të Bankës në përputhje me detyrimet e tyre përkatëse, në zbatim të marrëveshjes ligjore dhe të përmbushjes së qëllimeve të kësaj Huaje.

7. Kushtet e mëposhtme dhe përkufizimet e përcaktuara në shtojcë janë modifikuar dhe fshirë, dhe kushtet dhe përkufizimet e reja janë shtuar sipas një rendi alfabetik në shtojcë, si më poshtë, me kushtet e rinumërtuara, përkatësisht:

a) Përkufizimi i termit “Shpenzime të Pranueshme” është modifikuar dhe paraqitet si më poshtë:

“Shpenzime të Pranueshme” është çdo përdorim për të cilën Huaja vihet në mbështetje të Programit, të ndryshëm nga financimi i shpenzimeve të përjashtuara sipas Marrëveshjes së Huas”.

b) Termi “Pasqyrë Financiare” dhe përkufizimi i tij janë hequr tërësisht.

c) Termi “Projekt” është ndryshuar dhe paraqitet si “Program” dhe përkufizimi i tij modifikohet si më poshtë (dhe të gjitha referencat e “Projektit” të paraqitura në Kushtet e Përgjithshme, vlerësohen si referenca ndaj “Programit”):

“Program” është programi i referuar në Marrëveshjen e Kredisë, në funksion të qëllimit për të cilin është hartuar.”

LIGJ

Nr. 82/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR HUAN E POLITIKËS SË ZHVILLIMIT PËR MODERNIZIMIN E SEKTORIT FINANCIAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit për modernizimin e sektorit financiar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8662, datë 31.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Departamenti Ligjor (i ndryshueshëm)

Tekst i negociueshëm Nightingale Rukuba-Ngaiza

26 mars 2014

Numri i huas _____

MARRËVESHJE HUAJE

(HUA E PARË E POLITIKËS SË ZHVILLIMIT PËR
FINANCAT PUBLIKE) NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DATË
_____, 2014

Marrëveshje e datës _____, 2014, i lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), me synim dhënie e financimit në mbështetje të Programit (siç përkufizohet në shtojcën e Marrëveshjes). Banka ka vendosur të japë këtë financim në bazën, ndërmjet të tjerash, e: a) veprimeve që Huamarrësi ka ndërmarrë sipas Programit dhe të cilat janë përshkruar në seksionin I të grafikut 1 të kësaj Marrëveshjeje; dhe b) ruajtjes nga Huamarrësi të një kuadri të përshtatshëm politik makroekonomik. Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni I

Kushtet e përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përkufizohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet e veshura atyre në Kushtet e Përgjithshme (ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje).

Neni II

Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën e tetëdhjetë e shtatë milionë euro (€ 87,000,000 “Huaja”), ku kjo shumë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet kursit të këmbimit të monedhës në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07 të kësaj Marrëveshjeje (“Huaja”).

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë shumat e Huas në mbështetje të Programit, në pajtim me seksionin II të grafikut I të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa fillestare e pagueshme nga Huamarrësi është e barabartë me një e katërtën e një për qind (0.25%).

2.04 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo Periudhë Interesi do të jetë me normë të njëjtë sa Norma e Referencës për Valutën e Huas plus Marzhin e Pandryshueshëm; me kusht që, nëse ndodh një konvertim i së gjithës ose ndonjë pjese të shumës

principale të Huas, interesi i pagueshëm nga Huamarrësi gjatë Periudhës së Konvertimit mbi këtë shumë do të përcaktohet në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit IV të Kushteve të Përgjithshme. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse ndonjë shumë e Bilancit të Tërhequr të Huas mbetet pa paguar sipas afatit dhe një mospagim i tillë vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, atëherë interesi i pagueshëm nga Huamarrësi do të llogaritet siç parashikohet në seksionin 3.02 (e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.05 Datat e Pagesave janë 1 mars dhe 1 shtator të çdo viti.

2.06 Shuma principale e Huas shlyhet në pajtim me grafikun e amortizimit të parashikuar në grafikun 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 a) Huamarrësi në çdo kohë mund të kërkojë secilën nga ndryshimet e mëposhtme të termave të Huas në mënyrë që të lehtësojë administrimin e kujdesshëm të borxhit: i) ndryshimin e Valutës së Huas të së gjithës apo të një pjese të shumës principale të Huas, të disbursuar apo jo, në një Valutë të Miratuar; ii) ndryshim të bazës së normës së interesit të zbatueshme për: A) të gjithë ose ndonjë pjesë të shumës principale të Huas të disbursuar dhe të papaguar nga një Normë e Ndryshueshme në një Normë Fikse, ose anasjellas; ose B) të gjithë ose ndonjë pjesë të shumës principale të Huas të disbursuar dhe të papaguar nga një Normë e Ndryshueshme e bazuar në një Normë Referencë dhe Luhajtje të Ndryshueshme në një Normë të Ndryshueshme të bazuar në një Normë Reference Fikse dhe Luhajtjen e Ndryshueshme, ose anasjellas; ose C) të gjithë shumën principale të Huas të disbursuar dhe të pashlyer nga një Normë e Ndryshueshme e bazuar në një Luhajtje të Ndryshueshme në një Normë të Ndryshueshme të bazuar në Luhajtje Fikse.

b) Çdo këmbim i kërkuar sipas paragrafit (a) të këtij seksioni, që pranohet nga Banka, do të konsiderohet si “Këmbim”, siç përcaktohet në Kushtet e Përgjithshme dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit IV të Kushteve të Përgjithshme dhe udhëzimeve të këmbimit.

2.08 Pa u kufizuar në dispozitat e seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme (të rinumërtuar si i tillë sipas paragrafit 3 të seksionit II të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje, dhe në lidhje me Bashkëpunimin dhe Konsultimin), Huamarrësi i paraqet Bankës atë informacion në lidhje me dispozitat e nenit II, që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme here pas here.

Neni III Programi

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për Programin dhe zbatimin e tij. Për këtë qëllim, dhe në vijim të seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme:

a) Huamarrësi dhe Banka, herë pas here, dhe me kërkesë të një pale, shkëmbejnë mendimet për kuadrin e politikave makroekonomike të Huamarrësit dhe përparimin e arritur në zbatimin e Programit;

b) Para çdo shkëmbimi të tillë pikëpamjesh, Huamarrësi i jep Bankës për rishikim dhe koment një raport mbi përparimin e arritur në përmbushjen e programit, me detaje që Banka kërkon në mënyrë të arsyeshme; dhe

c) Pa u kufizuar në dispozitat e paragrafëve “a” dhe “b” të këtij seksioni, Huamarrësi informon menjëherë Bankën për çdo situatë që do të kishte efektin e pengimit serioz të objektivave të Programit ose çdo veprim të ndërmarrë sipas Programit.

Neni IV Mjetet mbrojtëse të Bankës

4.01. Ngjarja Shtesë e Pezullimit përbëhet nga një situatë që ka dalë dhe që e bën të pamundur që Programin apo një pjesë e konsiderueshme e tij të përmbushet.

Neni V Hyrja në fuqi; zgjidhja

5.01 Kushti Shtesë i hyrjes në fuqi përbëhet nga sa më poshtë që Banka është e bindur në lidhje me përparimin e arritur nga Huamarrësi në përmbushjen e Programit dhe me përshtatshmërinë e kuadrit të politikës makroekonomike të Huamarrësit.

5.02 Afati i hyrjen në fuqi është 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni VI Përfaqësuesit; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave.

6.02 Adresa e Huamarrësit është:
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë, Shqipëri
Faks: 355 42228494

6.03 Adresa e Bankës është:
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Adresa kabllore: Teleks: Faks:
INTBAFRAD 248423(MCI) ose 1-202-477-6391
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 64145(MCI)
United States of America

Rënë dakord më _____, _____, në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga:

Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM

Nga:

Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

GRAFIKU 1

MASAT E PROGRAMIT; DISPONIBILITETI I
SHUMAVE TË HUAS

Seksioni I

Masat sipas Programit

A. Masat e marra sipas Programit

Masat e marra nga Huamarrësi sipas Programit, përfshijnë sa më poshtë:

1. Këshilli i Ministrave i Huamarrësit, në pajtim me vendimin nr. 50, datë 2.2.2014, ka miratuar një strategji për shlyerjen dhe parandalimin e borxheve të prapambetura të qeverisë qendrore.

2. Në pajtim me vendimin nr. 15, datë 2.2.2014: a) ka verifikuar të gjitha detyrimet e prapambetura të qeverisë qendrore nga shtatori i vitit 2013 deri në fund të dhjetorit të 2013-ës; dhe b) ka bërë shpalljen për tender për një palë të jashtme të pavarur për të përfunduar një auditim të detyrimeve dhe të pretendimeve që nuk janë vlerësuar akoma për shkak të dokumentacionit të kundërshtueshëm ose të paplotë.

3. Huamarrësi, në pajtim me udhëzimin nr. 8, datë 7.3.2014, të shpallur nga MF-ja, ka njoftuar të gjitha ministrinë e linjës, që detyrimet financiare të këtyre ministrive për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, duhet të përmbushen brenda tavaneve të shpenzimeve të parashikuara, përkatësisht në buxhetin 2014 dhe në buxhetin afatmesëm 2015-2017.

4. Huamarrësi, në pajtim me udhëzimin suplementar nr. 3, datë 17.1.2014, në lidhje me udhëzimet e implementimit të buxhetit 2014 dhe udhëzimet e buxhetit afatmesëm 2015-2017, të shpallur nga MF-ja: a) u ka kërkuar të gjitha ministrive të vendosin një listë me prioritete për të gjitha shpenzimet për projektet me kosto të vlerësuar, më të madhe se pesë milionë euro (€ 5,000,000); dhe b) e ka marrë këtë listë nga të gjitha ministrinë.

5. Këshilli i Ministrave i Huamarrësit, në pajtim me udhëzimin shtesë nr. 3, datë 17.1.2014, u ka kërkuar të gjitha njësive të buxhetit të ministrive, të marrin nga MF-ja një konfirmim për disponibilitetin e fondeve

brenda buxheteve të tyre, të miratuara para fillimit të prokurimit për projektet e investimeve që do të financohen me fonde publike.

6. Parlamenti i Huamarrësit, në pajtim me ligjin nr. 177, datë 31.1.2013, ka rritur normën e tatimit mbi të ardhurat e shoqërive nga 10% në 15%.

7. Huamarrësi, në pajtim me urdhrin e Kryeministrit nr. 7, datë 17.1.2014: a) ka ngritur një grup pune ndërmintor për reformimin e pensione; dhe b) ka finalizuar një dokument politikash, datë 11.4.2014, që përcakton drejtimin strategjik për reformën e pensione.

8. Këshilli i Ministrave i Huamarrësit, në pajtim me vendimin e Këshillit nr. 141, datë 12.3.2014, ka miratuar një strategji për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të sektorit publik në sektorin e energjisë.

9. Huamarrësi, në pajtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 198, datë 3.4.2014, ka paguar një pjesë të detyrimeve të prapambetura të sektorit publik në sektorin e energjisë.

10. Huamarrësi, nëpërmjet rregullatorit shqiptar të energjisë, ka nxjerrë rezolutën nr. 146, datë 24.12.2013, që udhëzon "CEZ Shpërndarje" të zbatojë një normë të sheshtë për klientët shtëpiakë dhe "CEZ" ka filluar zbatimin e këtyre udhëzimeve.

SEKSIONI II

DISPONIBILITETI I SHUMAVE TË HUAS

A. Të përgjithshme. Huamarrësi mund të tërheqë shuma të huas në pajtim me dispozitat e këtij seksioni dhe ato udhëzime shtesë që Banka mund të specifikojë me njoftim drejtuar Huamarrësit.

B. Alokimi i shumave të Huas. Huaja (përveç shumave që kërkojnë për të paguar tarifën *front-end*) alokohet në dy një transhe të vetëm për tërheqje nga i cili Huamarrësi mund të bëjë tërheqjen e shumave të huas. Alokimi i shumave të huas, për këtë synim, përcaktohet në tabelën e mëposhtme:

Alokimet	Shuma e huas së alokuar (shprehur në euro)
1. Transhi i vetëm për tërheqje	86,782,500
2. Tarifa fillestare	217,500
SHUMA TOTALE	87,000,000

C. Kushtet e lirit të transhit për tërheqje

Asnjë tërheqje nuk bëhet nga transhi i vetëm i tërheqjes, përveç kur Banka bindet: a) që Programi po zbatohet nga Huamarrësi; dhe b) me përshtatshmërinë e kuadrit të politikës makroekonomike të Huamarrësit.

D. Depozitimi i shumave të Huas. Përveç kur Banka bie dakord ndryshe:

1. Të gjitha tërheqjet nga llogaria e Huas depozitohen nga Banka në një llogari të përcaktuar nga Huamarrësi dhe të pranueshme për Bankën; dhe

2. Huamarrësi garanton që për çdo depozitim të një shume të Huas në këtë llogari, përfshihet një shumë e barasvlershme në sistemin e menaxhimit të buxhetit të Huamarrësit, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

E. Shpenzimet e përjashtuara. Huamarrësi merr përsipër që shumat e Huas nuk do të përdoren për shpenzimet financiare të përjashtuara. Nëse Banka përcakton në çdo kohë që një shumë e Huas është përdorur për të bërë një pagesë për një shpenzim të përjashtuar, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit të Bankës, i rimbursos Bankës një shumë të barabartë me shumën e kësaj pagese. Shumat e rimbursuara Bankës, me kërkesë të tillë, do të anulohen.

G. Data e mbylljes. Data e mbylljes është 30 dhjetor 2015.

GRAFIKU 2

Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të Huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të Huas, të shlyeshme në çdo datë të pagesës së principalit (Shpërndarja e kësteve). Nëse shumat e huas janë tërhequr plotësisht në datën e parë të pagimit të principalit, shuma principale e Huas, e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagimit të principalit do të vendoset nga Banka, duke shumëzuar: a) balancën e disbursuar të huas në datën e parë të pagimit të principalit; me b) shpërndarjen e kështit për çdo datë pagimi principali [kjo shumë e shlyeshme duhet të përshtatet, sipas nevojës, duke zbritur çdo shumë të referuar në paragrafin 4 të këtij grafiku ndaj të cilit aplikohet këmbimi i valutës].

Data e pagesës së principalit	Pjesa e kështit (shprehur si përqindje)
Në çdo 1 mars dhe 1 shtator duke filluar nga data 1 shtator 2021 deri më 1 shtator 2036	3.13 %
Më 1 mars 2037	2.97 %

2. Nëse shumat e Huas nuk janë disbursuar plotësisht në datën e parë të pagimit të principalit, shuma principale e huas së shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë pagimi principali, do të vendoset si më poshtë:

a) Në masën që çdo shumë e huas, që është disbursuar në datën e parë të pagimit të principalit, Huamarrësi do të shlyejë balancën e huas së disbursuar në atë datë në përputhje me paragrafin 1 të këtij skeduli.

b) Çdo shumë e disbursuar pas datës së parë të pagimit të principalit do të shlyhet në çdo datë pagimi principali që vjen pas datës së një disbursimi të tillë në shuma të vendosura nga Banka, duke shumëzuar shumën e çdo disbursimi të tillë me një thyesë, numërori i së cilës është shpërndarja fillestare e kështit të specifikuar në tabelën e paragrafit 1 të këtij skeduli, për datën e përmendur të pagimit të principalit (Shpërndarja fillestare e kështit) dhe emëruesi i së cilës është shuma e të gjitha shpërndarjeve të mbetura fillestare të kështit për datat e pagimit të principalit,

që vijnë gjatë apo pas një date të tillë, shuma këto të shlyeshme, sipas nevojës, për t'u rregulluar, duke zbritur çdo shumë të referuar në paragrafin 4 të këtij skeduli, ndaj të cilit aplikohet këmbimi i valutës.

3.a) Shumat e huas së disbursuar, brenda dy muajve kalendarikë përpara çdo date pagimi principali, vetëm për qëllimet e llogaritjes së shumës principale të pagueshme në çdo datë pagimi principali, do të trajtohen si të disbursuara dhe të patërhequra në datën e dytë të pagimit të principalit pas datës së disbursimit dhe do të jenë të shlyeshme në çdo datë pagimi principali që fillon me datën e dytë të pagimit të principalit që pason datën e disbursimit.

b) Pavarësisht dispozitave të nënparagrafit "a" të këtij paragrafi, nëse në çdo kohë Banka miraton një sistem faturimi sipas të cilit faturat lëshohen para ose pas datave përkatëse të pagimit të principalit, dispozitat e këtij nënparagrafi nuk do të jenë më të zbatueshme për çdo disbursim të bërë pas miratimit të një sistemi të tillë faturimi.

4. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij skeduli, pas një këmbimi valute të së gjithës apo një pjese të balancës së Huas së disbursuar në një valutë të miratuar, shuma e konvertuar në këtë mënyrë në valutën e miratuar që është për t'u shlyer në çdo datë pagimi principali, që ndodh gjatë periudhës së këmbimit, do të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar këtë shumë në valutën e emërtuar menjëherë përpara këmbimit nëpërmjet: i) kursit të këmbimit, që reflekton shumat e principalit në valutën e miratuar të pagueshme nga banka, sipas transaksionit të valutës në kufi në lidhje me këmbimin; ose ii) nëse Banka vendos kështu në përputhje me udhëzimet e konvertimit, kompetentin e kursit të këmbimit të kursit zyrtar.

5. Nëse balanca e huas së disbursuar është shprehur në më shumë se në një valutë huaje, dispozitat e këtij skeduli do të zbatohen të ndara për çdo shumë të shprehur në secilën valutë huaje, në mënyrë që të paraqitet një skedul i veçantë amortizimi për çdo shumë të tillë.

SHTOJCË

SEKSIONI I. PËRKUFIZIME

1. "Rregullatori Shqiptar i Energjisë" është një subjekt publik i ngritur dhe që operon në pajtim me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003.

2. "Shpallja e Tenderit" është procesi i prokurimit ku furnitorët ftohen të bëjnë ofertën e tyre për të dhënë mallra ose shërbime jokonsulence.

3. "Këshilli i Ministrave" është dega e ekzekutivit e Huamarrësit e kryesuar nga Kryeministri.

4. "Tatim mbi të ardhurat e shoqërive" është tatimi i vendosur nga Huamarrësi mbi fitimet e shoqërive.

5. "Shpenzime të përjashtuara" është çdo shpenzim:

a) për mallrat ose shërbimet sipas një kontrate që e ka financuar ose ka rënë dakord ta financojë një institucion

ose agjenci financiare kombëtare ose ndërkombëtare e ndryshme nga Banka ose shoqata, ose Banka ose Shoqata ka financuar ose ka rënë dakord të financojë sipas një huaje, kredie, apo granti;

b) për mallrat e përfshira në grupet ose nëngrupet e mëposhtme të klasifikimit tregtar ndërkombëtar standard, rishikimi 3 (SITC, rishik 3), publikuar nga Kombet e Bashkuara në Dokumente Statistikore, seria M, nr. 34/Rishik/3 (1986) (SITC), ose çdo grup ose nëngrup pasues sipas rishikimeve të ardhme të SITC që përcaktohet nga Banka duke njoftuar Huamarrësin:

Grupi	Nëngrupi	Përshkrimi i artikullit
112		Pije alkoolike
121		Duhan i papërpunuar, mbetje duhani
122		Duhan i përpunuar (pavarësisht nëse ka zëvendësues duhani)
525		Material radioaktive ose shoqëruese
667		Perla, gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar, të punuar apo të papunuar
718	718,7	Reaktorë bërthamorë dhe pjesë të tyre, elemente karburanti (kartusha) të parrezatuar, për reaktorë bërthamorë
728	728.43	Makineri për përpunimin e duhanit
897	897.3	Sende të çmuara floriri, argjendi ose grupe metalesh platini (përveç orëve të dorës dhe kutive të orëve të dorës) dhe produkte të ar dhe argjend punuesve (duke përfshirë kompletet e rubinëve)
971		Ari, jomonetar (duke përfshirë xehorët ose koncentratet e arit)

c) për mallrat e destinuar për qëllime ushtarake ose paraushtarake ose për konsum luksoz;

d) për mallrat e dëmshëm për mjedisin, prodhimi, përdorimi ose importi i të cilëve ndalohet sipas ligjeve të Huamarrësit ose marrëveshjeve ndërkombëtare ku Huamarrësi është palë dhe çdo mall tjetër që përcaktohet si i dëmshëm për mjedisin me marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës¹⁾;

e) për shkak të çdo pagese të ndaluar me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të marrë sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara; dhe

f) në lidhje me të cilin Banka përcakton që praktikën e korruptuar, mashtruese, të fshehta ose detyruese janë zbatuar nga përfaqësues të Huamarrësit ose përfitues të tjerë të shumave të Huas, dhe Huamarrësi (ose një përfitues tjetër) nuk ka marrë masa në kohë dhe të pranueshme për Bankën për të trajtuar këto praktika kur ato ndodhin.

6. “Transhi i Vetëm i Tërheqjes” është shuma e Huas e caktuar në kategorinë “Transhi i Vetëm i Tërheqjes” në tabelën e përcaktuar në pjesën b të seksionit II të grafikut 1 të kësaj Marrëveshjeje.

7. “Kushte të Përgjithshme” janë “Kushtet e Përgjithshme për Huat të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim”, të datës 1 mars 2012 me ndryshimet e parashikuara në seksionin II të kësaj shtojce.

8. “Grupi i Punës Ndërmnistror për Reformën e Pensioneve” është grupi i punës i ngritur nga Huamarrësi në pajtim me urdhrin 7, datë 17.1.2014 për bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e reformës së pensione.

9. “MF” është Ministria e Financave e Huamarrësit ose pasuesi i saj ligjor.

10. “Programi i Buxhetit Afatmesëm 2015-2017” është programi i Huamarrësit i cili përcakton rregullimet fiskale për shtrirjen e horizontit për politikën fiskale pas vitit buxhetor.

11. “Program” është programi i masave, objekteve dhe politikave të hartuara për të përmirësuar qëndrueshmërinë fiskale të Huamarrësit nëpërmjet: a) fuqizimit të menaxhimit publik financiar për të zgjidhur çështjen e detyrimeve të prapambetura; dhe b) implementimit të reformave në sektorët e taksave, pensione dhe energjisë për të mbështetur qëndrueshmërinë makro-fiskale siç parashikohet ose përmendet në letrën e datës 31 mars 2014 nga Huamarrësi Bankës ku deklarohet përkushtimi i Huamarrësit për ekzekutimin e Programit dhe që kërkon asistencë nga Banka në mbështetje të Programit gjatë ekzekutimit të tij.

Seksioni II. Ndryshimet në Kushtet e Përgjithshme

Ndryshimet në Kushtet e Përgjithshme janë si më poshtë:

1. Fjalja e fundit e paragrafit (a) të seksionit 2.03 (në lidhje me Kërkesat për Tërheqje) fshihet në tërësinë e saj.

2. Seksionet 2.04 (Llogaritë e Destinuar) dhe 2.05 (Shpenzime të Përshtatshme) fshihen në tërësinë e tyre dhe seksionet e tjera në nenin II numërtohen përkatësisht.

3. Seksionet 5.01 (Ekzekutimi i Projektit në Përgjithësi) dhe 5.09 (Menaxhimi financiar, pasqyrat financiare; auditimet) fshihen në tërësinë e tyre dhe seksionet e tjera në nenin V numërtohen përkatësisht.

4. Paragrafi (a) i seksionit 5.05 (rinumërtuar si i tillë në pajtim me paragrafin 3 më sipër dhe në lidhje me përdorimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve) fshihet në tërësinë e tij.

5. Paragrafi (c) i seksionit 5.06 (rinumërtuar si i tillë në pajtim me paragrafin 3 më sipër) ndryshohet me tekstin si më poshtë:

“Seksioni 5.06. Planet; dokumentet; regjistrat

c) Huamarrësi mban të gjithë regjistrat (kontratat, porositë, faturat, hyrje-daljet dhe dokumente të tjera) që provojnë shpenzimet sipas Huas deri dy vjet pas datës së

mbylljes. Huamarrësi u mundëson përfaqësuesve të Bankës të kontrollojnë këto regjistra.”

6. Paragrafi (c) i seksionit 5.07 (rinumërtuar si i tillë në pajtim me paragrafin 3 më sipër) ndryshohet me tekstin si më poshtë:

Seksioni 5.07. Monitorimi dhe vlerësimi i programit

... (c) Huamarrësi përgatit ose merr masa për përgatitjen dhe i paraqet Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes, një raport me atë objekt dhe hollësi që Banka kërkon në mënyrë të arsyeshme, mbi zbatimin e Programit, përmbushjen nga Palët e Huas dhe Banka të detyrimeve të tyre përkatëse sipas Marrëveshjeve Ligjore dhe arritjen e qëllimeve të Huas.

7. Termat dhe përkufizimet e mëposhtme të përcaktuara në shtojcë ndryshohen ose fshihen si më poshtë dhe termat dhe përkufizimet e reja të mëposhtme shtohen në rend alfabetik në shtojcë si më poshtë, ku termat rinumërohen përkatësisht:

a) Përkufizimi i termit “Shpenzim i përshtatshëm” ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“Shpenzime të përshtatshme” janë çdo përdorim ku futet huaja në mbështetje të programit, të ndryshme nga shpenzimet financiare që përjashtohen në marrëveshjen e Huas.”

b) Termi “Pasqyra financiare” dhe përkufizimi i tij fshihen në tërësinë e tyre.

c) Termi “Projekt” ndryshohet dhe lexohet “Program” dhe përkufizimi i tij ndryshohet dhe lexohet si më poshtë (dhe të gjitha referencat të “Projektit” në të gjitha këto kushte të përgjithshme konsiderohen të jenë referenca të “Programit”).

“Programi” është programi i përmendur në Marrëveshjen e Huas në mbështetje të të cilit jepet Huaja.”

VENDIM

Nr. 52/2014

PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të nenit 33, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Besnik Dervishi zgjidhet në detyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ilir Meta

Miratuar në datën 24.7.2014

5648

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2013

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke konsideruar mbrojtjen e të drejtës së çdo personi për barazi para ligjit, parimin e barazisë dhe trajtimit për shanse dhe mundësi të barabarta, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminim, si përparësi kyçe drejt progresit të shtetit shqiptar;

- Duke inkurajuar dhe mbështetur veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion i pavarur, i cili ka mision garantimin për mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, bazuar në një listë joshteruese arsyesh, të përcaktuara në dispozitat kushtetuese dhe ligjore;

- Duke shprehur bindjen e tij se progresi i veprimtarisë së Komisionerit në drejtim të luftës kundër diskriminimit është i mundur vetëm në sajë të një sistemi harmonizimi dhe koordinimi real të të gjitha strukturave në nivel qendror e vendor, medias, shoqërisë civile dhe publikut;

Vlerëson:

- Zhvillimin institucional në drejtim të zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe përpjekjet për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese për barazi dhe mosdiskriminim ndaj çdo individi.

Konstaton se:

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka materializuar punën e tij bazuar në legjislacionin në fuqi, objektivat që përcakton Plani Strategjik 2012-2015 dhe Plani i Veprimit për vitin 2013, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit për veprimtarinë e tij institucionale gjatë vitit 2013.

- Ka paraqitur, bazuar në raportet zyrtare të institucioneve shtetërore, organizatave jofitimprurëse dhe gjetjeve të rezultuara gjatë veprimtarisë së tij, një vështrim të tipologjisë dhe fenomenologjisë së çështjeve aktuale të diskriminimit.

- Ka synuar zgjerimin e veprimtarisë së tij në drejtim të njohjes institucionale në publik, nëpërmjet shtrirjes rajonale të fushatave gjithëpërfshirëse të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit, lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri.

- Megjithatë ka rritje të konsiderueshme të numrit të ankesave të depozituara gjatë vitit 2013, në raport me vitet e kaluara, ky trend mbetet larg pritshmërive që ky institucion ka në përmbushje të misionit të tij ligjor.

- Ka rritur veprimtarinë proaktive duke dyfishuar numrin e çështjeve *ex officio*.

- Ka një numër të ulët të aplikimit të masës administrative “gjobë”.

- Ka ofruar mbështetje të nismave të ndryshme legislative, duke propozuar rekomandime ligjore në funksion të përmirësimit të legjislacionit në fuqi.

- Ka dhënë rekomandime të ndryshme drejtuar institucioneve përgjegjëse qendrore dhe vendore për përmirësimin e situatës për grupet vulnerabël, si dhe ka aplikuar ndërmjetësimin dhe mbështetjen ligjore të ankuesve me mbrojtje në proceset gjyqësore.

- Ka pasur mbështetjen dhe asistencën e vazhdueshme profesionale të organizmave ndërkombëtarë, që kanë objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Kuvendi kërkon nga KMD-ja për vitin 2014:

- Të fokusojë veprimtarinë institucionale në nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në vëmendje edhe të rekomandimeve të progres-raportit të BE-së për vitin 2013;

- Të ndërmarrë fushata më të gjera, informuese dhe sensibilizuese, për çështjet e diskriminimit, duke shfrytëzuar të gjitha instrumentet e mundshme, me qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe rritjen e identifikimit të rasteve apo ankesave;

- Monitorim më të thelluar të zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat;

- Kryerjen e sondazheve dhe të studimeve të pavarura dhe bërjen publike të trendit të zhvillimit të diskriminimit, në lidhje me subjekte dhe fusha të ndryshme të diskriminimit, me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen kundër fenomeneve të tij;

- Rritjen e aksesit të publikut për adresimin e rasteve të mundshme të diskriminimit, duke thelluar lidhjet e drejtpërdrejta me opinionin publik, për çfarëdo lloji çështjeje që lidhet me diskriminimin;

- Të rrisë transparencën institucionale përmes pasurimit të faqes zyrtare të institucionit, duke pasqyruar të gjitha vendimet e ankesave të shqyrtuara, informacione të plota dhe të përditësuara, si dhe të mundësojë portale, forume dhe anketime *online*, të aksesueshme për publikun, me qëllim sigurimin e një komunikimi të vlefshëm, në kohë dhe në interes të qytetarëve;

- Të ketë një bashkëpunim më të ngushtë dhe të materializojë bashkëveprimin midis Avokatit të Popullit dhe KMD-së për çështjet e referuara në këto dy institucione;

- Aplikimin e një politike më strikte në përmbushje të sanksioneve administrative, sipas përcaktimeve të ligjit;

- Rritjen e numrit të hetimeve administrative dhe atyre kryesisht;

- Respektimin e afateve ligjore në procesin e hetimit administrativ gjatë shqyrtimit të ankesave.

- Zgjerimit të mbledhjes së të dhënave dhe informimit nga institucionet publike qendrore dhe vendore përgjegjëse sipas ligjit, si dhe ndërhyrjes me veprime konkrete për zbatimin e masave që rrjedhin nga detyrimet ligjore të këtyre institucioneve;

- Intensifikimin e konsultimeve për ndryshimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, si pasojë e pengesave ligjore të konstatuara gjatë zbatimit të tij.

- Angazhim publik të KMD-së në median kombëtare (vizive dhe të shkruar) me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin të qytetarëve lidhur me misionin dhe kompetencat ligjore të KMD-së si institucion, i cili shqyrton çështjet e diskriminimit.

- Vazhdimin e promovimit të praktikave më të mira në këtë fushë, me theks të veçantë në diskriminimin gjinor, grupet vulnerabël, me qëllim sensibilizimin e opinionit publik, lidhur me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi.

- Përfshirjen në raport të arsytimit për mospranimin e ankesave që janë jashtë juridiksionit dhe kompetencës, për efekte studimore dhe informuese, lidhur me nivelin e perceptimit që qytetarët kanë për institucionin.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 24.7.2014

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2013

Kuvendi i Shqipërisë, duke konsideruar se:

- KQZ-ja është institucioni kryesor përgjegjës për përgatitjen, organizimin, administrimin e zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultatit të tyre;

- Veprimtaria e KQZ-së, në përgjithësi, dhe vendimmarrja e tij, në veçanti, janë me rëndësi themelore, si dhe në lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me suksesin e procesit zgjedhor dhe standardin e tyre;

- Veprimtaria e KQZ-së duhet të udhëhiqet nga parimet e pavarësisë politike dhe institucionale, paanësisë, integritetit, transparencës, profesionalizmit, eficientë;

- Zhvillimi i zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të ndershme, në respektim të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990 dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të KiE-së përbën përgjegjësi themelore të veprimtarisë e të funksionit të KQZ-së;

Pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mbi veprimtarinë e vitit 2013, konstaton se:

- KQZ-ja përgatiti, administroi dhe shpalli, sipas rastit, rezultatin zgjedhor të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin, të datës 23 qershor, si dhe të disa

zgjedhjeve të pjesshme për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore;

- Vendimmarrja e KQZ-së, në lidhje me disa aspekte të përgatitjes së zgjedhjeve të 23 qershorit, si dhe me shpalljen e rezultatit të tyre, në një numër rastesh nuk respektoi parimin e paanësisë;

- Për zgjedhjet e vitit 2013, KQZ-ja nuk përmbushi disa afate ligjore, lidhur me aplikimin e projekteve SEN, SEV dhe nuk arriti të përshtatë rregullat e nevojshme për implementimin e projekteve pilot, megjithëse kërkohej më tepër kohë nga sa pati KQZ-ja në dispozicion për rastin konkret;

- Procesi i trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GN-ve rezultoi me problematika;

- Vendimi i KQZ-së për të ndryshuar përbërjen e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, duke zëvendësuar të gjithë anëtarët e 89 komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor (KZAZ), të emëruar nga partia e dytë më e madhe e opozitës, përveçse jo i bazuar ligjërisht, ishte në vazhden e një sërë vendimmarrjesh të konsideruara të motivuara politikisht;

- Në vendimmarrjen e KQZ-së janë vërejtur një sërë shkeljesh me karakter procedural, si në rastin e vendimit për të mos miratuar ndarjen e re të ZAZ-ve dhe në rastet e moscastimit të rendit të ditës për mbledhjen pasardhëse, apo për mosndryshimin e rendit të ditës me kërkesë të anëtarëve të KQZ-së;

- KQZ-ja në disa raste nuk ka respektuar afatet ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në Planin Orientues të Veprimit për vendimmarrjen e tij, si dhe ka cenuar vetë apo ka lejuar cenimin e ceremonialitetit të mbledhjeve të veta;

- KQZ-ja nuk i ka paraqitur të plota vendimmarrjet në faqen e saj të internetit, sikundër parashikon ligji;

- KQZ-ja mori në shqyrtim ankesat kundër rezultateve, edhe pse me përbërje të reduktuar nuk duhet ta bënte këtë. Në këtë proces KQZ-ja pranoi të shqyrtojë ankesat e partive të mëdha, duke refuzuar rregullisht ankesat e partive të vogla;

- KQZ-ja nuk respektoi ligjin zgjedhor, lidhur me shumicën e kërkuar në vendimmarrjet e saj, duke miratuar akte normative dhe disa vendime me shumicë të thjeshtë, në vend të shumicës së cilësuar, siç e kërkon Kodi Zgjedhor;

- Puna për saktësimin e të dhënave dhe koha e kërkuar nga partitë politike për të verifikuar rezultatet e pasqyruara në projektaktin e KQZ-së me tabelat e ZAZ-ve dhe QV-ve, solli si pasojë tejkalimin e afatit ligjor për miratimin e Tabelave Përmbledhëse të Rezultatit për çdo zonë zgjedhore, të përcaktuar në nenin 123 të Kodit Zgjedhor;

- Rritja e numrit të KZAZ-ve, si dhe ndryshimet ligjore, sa i përket procedurave që ndiqen gjatë procesit të numërimit, ndihmuan në përshpejtimin e procesit të

numërimit, dhe zbehjen e situatave bllokuese gjatë procesit nga KZAZ-të apo GNV-të;

- Procesi dhe dita e zgjedhjeve në tërësi u vlerësuan edhe nga misionet e vëzhgimit dhe monitorimit, vendase dhe ndërkombëtare, me standard demokratik të realizuar;

- Bordi i Monitorimit të Medias u ngrit përtej afateve ligjore nga ana e KQZ-së dhe efektiviteti i tij ishte i reduktuar, si pasojë e mungesës së kolegjalitetit. KQZ-ja nuk zbatoi në mënyrë efikase dispozitat ligjore në lidhje me median;

- KQZ-ja nuk ka respektuar detyrimin ligjor për shqyrtimin e raporteve javore të Bordit të Monitorimit të Mediave;

- Vendimet e KQZ-së, lidhur me transmetimet në media të materialeve të përgatitura nga subjektet zgjedhore, tejkaluan vendimet e mëparshme të gjykatave, kompetencat e KQZ-së dhe standardet e OSBE-së dhe Këshillit të Evropës;

- Disa vendime të KQZ-së nuk ishin të arsyetuara ligjërisht dhe në jo pak raste KQZ-ja tejkaloi kompetencat e saj rregullatore;

- Procesi i numërimit të votave, në përgjithësi rezultoi pozitiv.

Kuvendi, për vitin 2014 i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në mënyrë të veçantë fokusimin në këto drejtime:

- Të hartojë një program pune në funksion të përgatitjes së zgjedhjeve të ardhshme për organet e qeverisjes vendore, ku të parashikojë se çfarë do të bëjë KQZ-ja;

- Të evidentojë problematikat që lidhen me përgatitjen, administrimin dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve, si dhe adresimet për ndryshime ligjore nëse është rasti;

- Të përmbushë rekomandimet e Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, të pas zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2011 dhe ato për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013, që i adresohen KQZ-së dhe/ose lidhen me veprimtarinë e saj;

- Të zhvillojë programe intensive të edukimit të zgjedhësve, veçanërisht për disa kategori të veçanta, si votuesit për herë të parë, votueset e gjinisë femërore etj.;

- Të bashkëpunojë ngushtë dhe në mënyrë periodike me partitë politike për përgatitjen dhe zhvillimin e programeve për trajnimin e administratës zgjedhore në të gjitha nivelet;

- Të rendisë të gjitha nevojat për infrastrukturën e përgatitjes dhe të zhvillimit të zgjedhjeve, duke i kërkuar Qeverisë që të ofrojë mbështetje në këtë aspekt;

- Të përgatisë draftet e të gjithë vendimeve dhe udhëzimeve që do të miratohen në bazë dhe për zbatim të Kodit zgjedhor, duke i konsultuar ato gjerësisht me

partitë politike;

- Të përgatisë një projektbuxhet për zhvillimin e zgjedhjeve të ardhshme, përfshirë këtu edhe buxhetin për financimin e fushatës së partive politike, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor;

- Të vlerësojë mundësinë e aplikimit të teknologjisë së informacionit në procesin e zhvillimit të zgjedhjeve, si dhe atë të shpalljes së rezultatit të tyre;

- Të krijojë kushtet për evidentimin dhe realizimin e infrastrukturës përkatëse për të mundësuar votimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara;

- Të ndërtojë një administratë profesionale dhe larg ndikimit politik.

KRYETARI

Ilir Meta

Miraturar në datën 24.7.2014

VENDIM

Nr. 11, datë 1.8.2014

PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR ARSIMIN, FONDI I ZHVILLIMIT TË RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, "Për buxhetin e vitit 2014", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte në fushën e arsimit (arsimi bazë, i mesëm dhe profesional), në vlerën 260 000 000 (dyqind e gjashtëdhjetë milionë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, duhet të paraqesin pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Arsimit, brenda një muaji nga publikimi i këtij vendimi, një kalendar me të gjitha afatet e prokurimit publik dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve (realizimit të investimit), për të vlerësuar realizimin e investimeve.

3. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas tabelës 1 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin

e punimeve të ndërtimit deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014. Për fondet e projekteve të paprocuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe rialokimin e fondeve të këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit të bëjë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Njësisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, sipas kalendarit të paraqitur nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas pikës 3 të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Arsimit, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar
Ministri i Financave	Anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar
Ministri i Kulturës	Anëtar
Ministri i Mjedisit	Anëtar
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar

TABELA 1. PROJEKTET E ARSIMIT, THIRRJA II PËR FINANCIM
NGA FONDI I ZHVILLIMIT TË RAJONEVE

Nr	Autoriteti Kontraktues	Titulli i projektit	Programi	Vlera e plotë e projektit	Vlera e financimit 2014
QARKU BERAT					
1	Bashkia Berat	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Thimi Tani” Bashkia Berat	09120	31,765,895	15,882,948
2	Bashkia Ura Vajgurore	Sistemim, rrethim oborri, ndërtim palestre shkolla e bashkuar, lagjia “4 Shtatori” Ura Vajgurore	09120	35,160,733	17,580,367
3	Komuna Gjerbës	Rikonstruksion pjesor, shkolla 9- vjeçare	09120	5,385,450	5,385,450
QARKU ELBASAN					
4	Komuna Rrajcë	Ndërtim shkolla CU Urakë, Komuna Rrajcë	09120	9,000,538	4,500,269
5	Komuna Orenjë	Ndërtim shkolla vartëse Fshati Zdrajsh Verri, Komuna Orenjë	09120	4,164,354	4,164,354
6	Komuna Qendër Librazhd	Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Babje, Komuna Qendër Librazhd	09120	6,699,984	5,359,987
7	Komuna Qukës	Rikonstruksion shkolla 9- vjeçare “Naim Frashëri” Pishkash, Komuna Qukës	09120	9,703,918	4,851,959
8	Bashkia Përrenjas	Rikonstruksion dhe rrethim shkolla e mesme “Halit Bërzështa” Përrenjas, Bashkia Përrenjas	09240	16,262,336	8,131,168
9	Bashkia Elbasan	Përfundim i punimeve në shkollën Xhafer Hakani, Elbasan	09120	12,000,000	6,000,000
10	Komuna Kukur	Rikonstruksion shkolla e bashkuar “Muharrem Zela”, Komuna Kukur	09120	21,205,703	10,602,852
QARKU KUKËS					
11	Bashkia Krumë	Rikonstruksion i shkollës 9- vjeçare Zahrisht, faza II, Bashkia Krumë	09120	14,325,611	7,162,806
QARKU DIBËR					
12	Komuna Kala e Dodës	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare dhe ndërtim palestre Radomirë, Komuna Kala e Dodes	09120	42,616,229	21,308,115
QARKU FIER					
13	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës 9- vjeçare “Andon Xoxa” Fier	09120	34,635,910	17,317,955
14	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës 9- vjeçare “Jani Bakalli”, Fier	09120	22,107,222	11,053,611
QARKU GJIROKASTËR					
15	Komuna Qesarat	Rikonstruksion shkolla CU fshati Anë-Vjosë, Komuna Qesarat, Tepelenë	09120	5,785,412	5,785,412
QARKU KORÇË					
16	Komuna Libonik	Ndërtim i shkollës cikli ulët, fshati Pocestë, Libonik	09120	14,010,895	7,617,097
QARKU SHKODËR					
17	Komuna Shalë	Rikonstruksioni i shkollës 9- vjeçare fshati Gimaj, Komuna Shalë	09120	30,500,358	15,250,179
18	Komuna Fierzë	Ndërtim i shkollës 9 vjeçare, fshati Mëzi, Pukë	09120	29,026,868	14,513,434
QARKU LEZHË					
19	Komuna Blinisht	Rikonstruksion i shkollës “Pjetës Zahrishi”, Komuna Blinisht, Lezhë	09120	21,472,848	10,736,424
QARKU TIRANË					
20	Njësia Bashkiake nr. 2	Rikonstruksion i nyjave sanitare, Shkolla Ekonomike Tiranë	0924	900,000	900,000
QARKU VLORË					
21	Komuna Vranisht	Rikonstruksion shkolla e bashkuar Horë Vranisht, Komuna Vranisht	09120	46,071,231	23,035,616
22	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion i shkollës 9- vjeçare “Zigur Lelo” Vlorë, Bashkia Vlorë	09120	22,029,600	11,014,800
23	Komuna Finiq	Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare dhe kopshtit, Finiq	09120	79,613,000	31,845,200
TOTALI				514,444,095	260,000,000

Shënim: “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).

“Vlera e financimit” për vitin 2014 tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.

Diferenca e financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014, do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2015.

VENDIM
Nr. 12, datë 1.8.2014

PËR DETAJIMIN E PËRDORIMIT DHE NDARJES
SË FONDIT PËR INFRASTRUKTURËN
VENDORE, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN
E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve
VENDOSI:

1. Përdorimin e fondeve në vlerën prej 1 295 000 000 (një miliard e dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë) lekësh, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, për infrastrukturën vendore, të cilat përbëhen nga:

a) Fondi 955 000 000 (nëntëqind e pesëdhjetë e pesë milionë) lekë të papërdorura nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve;

b) Fondi 340 000 000 (treqind e dyzet milionë) lekë, pjesë e financimit të papërdorur për projekte të miratuara për financim gjatë vitit 2014, si diferencë midis vlerës së miratuar dhe vlerës së kontraktuar (në përfundim të procedurave të prokurimit publik dhe kontraktimit të kryerjes së punimeve) për infrastrukturën vendore.

2. Fondi prej 1 295 000 000 (një miliard e dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë) lekësh, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, të përdoret për infrastrukturën vendore, si më poshtë vijon:

a) 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë, për financimin e projekteve, në përputhje me pikën 3 të këtij vendimi;

b) 590 000 000 (pesëqind e nëntëdhjetë milionë) lekë, për financimin e përfundimit të punimeve të ndërtimit për projektet në vazhdim, të miratuara nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve gjatë periudhës 2012 dhe 2013, sipas pikës 7 të këtij vendimi;

c) 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për supervizimin dhe kolaudimin e objekteve me autoritet kontraktues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, të financuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, përgjatë vitit 2014. Fondi Shqiptar i Zhvillimit kryen detajimin e këtij fondi, për çdo objekt të miratuar, sipas nevojës.

3. Shpërndarja e fondit të përcaktuar sipas shkronjës “a” të pikës 2, të bëhet duke marrë në shqyrtim aplikimet e deritanishme për projekte të infrastrukturës vendore, si edhe ato aplikime që paraqiten, nga institucionet aplikuese (njësitë e qeverisjes vendore dhe agjencitë e zhvillimit) brenda hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Konsiderohen të vlefshme për aplikim projektet që përputhen me fushat për financim, sipas pikave 4, 5 e 6 të këtij vendimi.

4. Fondi prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh, pjesë e fondit të përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 2, do të shpërndahet për aplikime:

i) për projekte zhvillimi të ekonomive vendore, kryesisht në zona qendër-qarqe me rëndësi të veçantë nga pikëpamja turistike dhe potenciale për ekonomi lokale dhe zona të përmirësuar biznesi;

ii) për projekte rivitalizimi dhe rikualifikimi urban, ku synohet përmirësimi në qendra të mëdha urbane, përmes nxitjes së bërthamave social-kulturore të shërbimeve publike, të trashëgimisë kulturore etj.;

iii) për projekte të tjera të vogla me impakt vendor e rajonal.

5. Fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh, pjesë e fondit të përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 2, do të shpërndahet për aplikime për projekte të rehabilitimit mjedisor dhe krijimit të korridoreve të gjelbra ndërqytetëse, si dhe në zona turistike.

6. Fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh, pjesë e fondit të përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 2, do të shpërndahet për hartimin e studimeve dhe projekteve për projekte zhvillimi me impakt rajonal dhe lokal.

7. Fondi prej 590 000 000 (pesëqind e nëntëdhjetë milionë) lekësh, pjesë e fondit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të përdoret për financimin e përfundimit të punimeve të ndërtimit për projektet në vazhdim, të miratuara nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve gjatë periudhës 2012 dhe 2013. Merren në konsideratë për financim projektet që janë në nivelin e mbi 50% të zbatimit të punimeve të kontraktuara, për të cilat është kryer një vlerësim paraprak nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në lidhje me vlerësimin teknik e financiar, ecurinë e zbatimit të punimeve, si edhe cilësinë dhe impaktin në zhvillimin e zonave ku po zbatohen.

8. Procedura e vlerësimit për projektet e aplikuara sipas pikave 4, 5 e 6, të këtij vendimi, kryhet pranë sekretariateve përkatëse teknike në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, si dhe pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas kriterëve të dhëna në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi.

9. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Financave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar
Ministri i Financave	Anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar
Ministri i Kulturës	Anëtar
Ministri i Mjedisit	Anëtar
Ministri i Brendshëm	Anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar

SHTOJCË I

KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Pika A. Kriteret e vlerësimit teknik

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe, në bazë të tyre, kryhet vlerësimi maksimalisht me 70 pikë i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik për projektet e infrastrukturës vendore, i ngritur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet, që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë, si dhe ato projekte, ku kostimi i projektit dhe preventivi është përpiluar dhe vlerësuar nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen për financim, duke pasur një vlerësim me pikë nga 0 deri maksimalisht 25 pikë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si pjesë e sekretariatit teknik, ngarkohet të kryejë rishikimin financiar të kostimit dhe preventivave të projekteve me potencial, të paraqitura nga aplikantët, sipas buletineve të çmimeve, kostove referencë etj., si dhe të përgatitë raportin e vlerësimit financiar të tyre dhe rekomandimet përkatëse.

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që

orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me 0 deri maksimalisht 10 pikë.

3. Ndikimi i projektit që vlerësohet me maksimalisht 0 deri në 10 pikë, sipas komponentëve, si më poshtë vijon:

a) Prek qendër-qarkun dhe ndikon në zhvillimin ekonomive vendore, konsolidimin e strukturës ekonomike të zonave apo qarqeve të ndryshme. Për këtë komponent, vlerësimi përfshin 0 deri 5 pikë.

b) Me rëndësi të veçantë nga pikëpamja turistike dhe potenciale për ekonomi lokale dhe zona të përmirësuara biznesi. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në maksimalisht 5 pikë.

c) Rivitalizimi dhe rikualifikimi urban, ku synohet përmirësimi në qendra të mëdha urbane, përmes nxitjes së bërthamave social-kulturore, të shërbimeve publike, të trashëgimisë kulturore etj. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në maksimalisht 5 pikë.

d) Projekti ndikon në rehabilitimin mjedisor dhe krijimin e korridoreve të gjelbër ndërqytetëse, si dhe në zona turistike. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në maksimalisht 5 pikë.

4. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me 0 deri maksimalisht 5 pikë.

Pika B. Kriteret e vlerësimit strategjik

Përdoren nga sekretariati i përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar në nivel vendor, qarku apo kombëtar, duke vlerësuar një projekt me maksimalisht 30 pikë, sipas kriterëve në vijim:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal/kombëtar dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonat/kombëtar. Niveli i potencialit për nxitjen e ekonomive lokale dhe zona të përmirësuara të biznesit; krijimi i poleve të zhvillimit urban të qendër-qarqeve. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.

2. Potenciali për zhvillim, qëndrueshmëria dhe për tërheqjen për investime të reja dhe/apo faza të reja të zhvillimit, që paraqet projekti. Niveli i ndikimit për zhvillimin e qëndrueshëm në mjedis. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.

KËRKESË

Nr. 3460, datë 31.7.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Kulturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë

private, që preken nga zbatimi i projektit të miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve nr. 27, datë 15.7.2014, “Për ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin “Nënë Tereza”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës. Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 30.7.2014, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin

pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Kulturës.

Pronarët për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, do të likuidohen për efekt shpronësimi pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 36,107,184 (tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh.

ZËVENDËSMINISTRI I KULTURËS

Zef Çuni

LISTA E PASURIVE TE PALUAJTESHME PRONE PRIVATE QE DO TE SIPRONESOHEN PER MARRIEN NE PERDORIM TE PERKOHSEM PER INTERES PUBLIK, TE CILAT PREKEN NGA

Nr	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Superfaqe		Çmimi Leka/m2		Vlera Leka			SHENIME
				Tfuall	Ndertim	Tfuall	Ndertim	Tfuallit	Ndertese	Banese	
1	FLUTURA HASAN CELA, LILJANA PETROR SOTIRI, NAZE HASAN SUBASHI, QEMAL GEGA, VIOLLCA NAGJELI SHITETI	8280	2/8-ND		104		12445.71		1,294,354		Plotesim dokumentacioni
2	HODO VELAJ SHITET	8160	7/11-N2		94.5		25769.97		2,435,262		Plotesim dokumentacioni
3	ROVAN LIMON LUKU	8280	2/327	72m2	299.8	23955	43894.79	1,724,760	13,159,659		Blokuar ne favor te UNION BANK
4	PERSEFONI KRISTO KOKA	8280	2/13	51m2	60.9	23955	23944.33	1,221,705	1,458,210		Konfirmuar nga ZRVPp
5	MAILINDA XHEVAHIR ZALLA VIPAUTO sh.p.k. VIPAUTO SH.P.K. LIONMAX KONSTRUKSION		2/337 2/336 8280 2/11 2/267	22.9m2 22.9m2 31.6m2 25.5m2	104.5	23955	65961.67	2,464,970	6,892,995		2/11 bllokuar ne favor te UNION BANK 2/336 Bllokuar ne favor te UNION BANK
6	MAK-ALBANIA sh.p.k. SHITET	8160	7/11-N3		140		34241.91		4,793,867		Plotesim dokumentacioni
7	LILJANA PETRO SOTIRI VIOLLCA RUSHIT ANGJELI FLUTURA HASAN CELA QEMAL LIAL GEGA NAZE SUBASHI SHITET	8280	2/334-ND/2 2/334-ND/1	40m2	48.9		13525.6		661,402		Plotesim dokumentacioni
8	HODO VELAJ	8160	7/11-N4	0	0		0		0		
9											
TOTALI					852.6			5,411,435	30,695,749	-	36,107,184

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 36 lekë

Adresa: bulevardi “Gjergj Fishta”, pas ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006